AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Infermieri Mami"**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Etleva Refatllari
2. Doc. Dr. Julian Kraja

Muaji/Viti

Shtator 2024

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**
**Për Programin e studimit Bachelor në "Infermieri Mami" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti Infermierisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Infermieri Mami" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Nr. 420 datë 27.06.2012 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Shkresë MAS Nr. 05.02.2016 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | I parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 11 PAE/ 6 PAK v.a. 2022-2023<br>11 PAE/ 6 PAK v.a. 2021-2022<br>10 PAE/ 11 PAK v.a. 2020-2021 |
| 18 | Numri i studentëve: | 7 studentë v.a. 2022-2023<br>14 studentë v.a. 2021-2022<br>12 studentë v.a. 2020-2021 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

# PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej" (UGJ) është institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me VKM Nr. 414, datë 12.11.1991. UGJ ka marrë akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 67, date 21.09.2017. UGJ është riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 55, date 16.12.2021 për një periudhë 4 vjeçare. Ky institucion i arsimit të lartë është ngritur mbi eksperiencën 20 vjeçare të Institutit të Lartë Pedagogjik (hapur me VKM Nr. 4 datë 08.01.1971) dhe me zhvillimin dhe ristrukturimet e vazhdueshme, prezantohet sot si institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor dhe kulturor për rajonin jugor të Shqipërisë.

Programi i studimit Bachelor në "Infermieri Mami" është hapur hapur me VKM Nr. 420, datë 27.06.2012. Programi zhvillohet në Departamentin e Infermierisë (DI) të Fakultetit i Shkencave Mjekësore të Natyrës. Ky program është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe ofrohet në përputhje me fushën akademike të FSHN dhe Departamentit të Infermierisë që është përgjegjës për këtë program studimi.

Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" është organizuar dhe strukturuar në përputhje më statusin dhe rregulloret e institucionin, Ligjin 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë " si dhe akteve nënligjore në fuqi për IAL-të. Ai është program i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Programi zhvillohet me kohë të plotë, organizohet në lëndë e module të vlerësuara në ECTS. Programi ka një shtrirje në 3 vite akademike (6 semestra) dhe vlerësohet me 180ECTS të shpërndara uniformisht gjatë 3 viteve.

Departamenti i Infermierisë që ofron programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" përmbush përgjithësisht kërkesat ligjore dhe standartet e cilësisë së stafit akademik për ofrimin e tij. DI dhe FSHN përmbushin standartet infrastrukturore për ofrimin e programit të studimit.

Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të ofruar shërbim me një nivel të lartë profesional në fushën Infermier-Mami duke përdorur sistemet e reja të teknologjisë infermierore. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

### Përshkrim përmbledhës

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit Bachelor në "Infermier-Mami", i ofruar nga Fakulteti i Shkencave tw Natyrws në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër (UGJ). Ky raport përmbledh proçedurën e realizimit të këtij proçesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit, Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat, Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit, Studentët dhe mbështetja e tyre, Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen
- Standardet përmbushen pjesërisht
- Standardet përmbushen kryesisht
- Standardet përmbushen plotësisht

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

Dokumentacioni i referuar listohet për çdo kriter dhe standard (Evidencat).

Proçesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Etleva Refatllari dhe Doc. Dr. Julian Kraja. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proçes vlerësimi është Msc. Aviola Bardh.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në proçedurën e vlerësimit, proçesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në UGJ e zhvilluar në datat 6 – 7 Dhjetor 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të proçesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UGJ.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të proçesit gjatë vizitës në institucion.

Me datë 23.07.2024, GVJ dergoi në IAL draft Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, nëpërmjet sistemit AMS. Me datë 29.07.2024, IAL shprehu dakordësinë rreth draft RVJ-së dhe nuk kishte komente në lidhje me të. Ky raport merr formë finale, duke përfshirë edhe analizën e pikave të forta dhe të dobta si më poshtë.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Infermieri Mami"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej" (UGJ) është institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me VKM Nr. 414, datë 12.11.1991. UGJ ka marrë akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 67, date 21.09.2017. UGJ është riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 55, date 16.12.2021 për një periudhë 4 vjeçare.<br>Ky institucion i arsimit të lartë është ngritur mbi eksperiencën 20 vjeçare të Institutit të Lartë Pedagogjik (hapur me VKM Nr. 4 datë 08.01.1971) dhe me zhvillimin dhe ristrukturimet e vazhdueshme, prezantohet sot si institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor dhe kulturor për rajonin jugor të Shqipërisë. UGJ është i organizuar në tre Fakultete (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Fakulteti Ekonomik) dhe ofron 43 programe studimi:<br>– 18 programe të ciklit të parë<br>– 18 programe të ciklit të dytë<br>– 4 programe Master Shkencor<br>– 1 program Doktoraturë në albanologji<br>– 6 programe profesionale 2 vjeçare<br>UGJ bën përpjekje të vazhdueshme që përmes ofrimit të dijeve në nivele bashkëkohore të ruajë dhe konsolidojë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare.<br>UGJ deklaron në statut se organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi. Në organizimin dhe funksionimin e tij, UGJ respekton parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.<br>Në nenin 4 të statutit të institucionit theksohet veç të tjerash se UGJ synon të jetë model i arsimit të lartë publik, të arrijë standarde cilësore në fushën akademike dhe të përgatisë profesionistë të zotë sipas programeve përkatëse të studimit, të rrisë cilësinë e kërkimit në fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të jetë |

| | |
|---|---|
| | qendër e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të Rajonit Jugor të Shqipërisë.<br>Në misionin e UGJ theksohet kontributi në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe kontributi në rritjen e standardeve të demokracisë dhe të qytetërimit të shoqërisë si dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë.<br>Programet e studimit të ofruara nga UGJ janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të arsimit të lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë.<br>*(Evidencat I.1-Statuti i UGJ, 5-Strategjia e zhvillimit të UGJ, I.6-Strategjia e zhvillimit të FSHN, I.21-Vendimi i akreditimit institucional)* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" ofrohet nga Departamenti i Infermierisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) të UGJ. Ai u miratua si program i ciklit të parë të studimeve me VKM Nr. 420, datë 27.06.2012. Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.<br>Programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë.<br>Në dokumentin e strategjisë së zhvillimit të FSHN theksohet ndër të tjera se FSHN synon të identifikohet si pikë referimi në fushën e edukimit dhe përgatitjes së burimeve njerëzore të aftë profesionalisht e të gatshëm të përballojnë sfidat dhe kërkesat e tregut të punës, sipas sektorëve strategjikë të zhvillimit rajonal dhe kombëtar.<br>Në mënyrë specifike në rregulloren e programit të studimit Bachelor "Infermier-Mami" theksohet se qëllimi i Programit të studimit është të përgatisë specialist që janë të aftë të përdorin sisteme të reja të teknologjisë infermierore për shëndetin e gruas në një nivel të lartë profesional. Të diplomuarit në këtë program studimi do të jenë të aftë të veprojnë si mami, programues të politikave shëndetësore për shëndetin e gruas, si administrator të të dhënave në stuktura spitalore apo në konsultore.<br>*(Evidencat I.1-Statuti i UGJ, I.3-Strategjia e zhvillimit të UGJ, I.6-Strategjia e zhvillimit të FSHN, I.9-Rregullore e programit të studimit)* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | UGJ dhe FSHN, ofrues të programit të studimit Bachelor "Infermieri-Mami" e bazojnë veprimtarinë e tyre në Statutin dhe rregulloret e institucionit. Mbështetur në këto dokumenta bazë të funksionimit të institucionit hartohen rregulloret e programeve të studimit dhe strategjitë e zhvillimit. Vizioni i UGJ i shprehur në dokumentin e strategjisë së zhvillimit 2020 – 2025 është përshtatja me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit duke e kthyer UGJ në qendër të fuqishme për arsimin dhe kërkimin shkencor të orientuar nga tregu i punës dhe reformat socio-ekonomike si dhe në qendër të edukimit të vazhdueshëm në rajonin e jugut. |



Bellaiimi

| | |
|---|---|
| | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe ofrohet në përputhje me fushën akademike të FSHN dhe Departamentit të Infermierisë që është përgjegjës për këtë program studimi.<br>Në funksion të qëllimit të UGJ për krijimin e kapaciteteve reale për shoqërinë, diktuar nga nevojat e progresit të shoqërisë në të gjitha fushat, nga zhvillimi i shkencës, teknikës dhe teknologjisë, Departamenti i Infermierisë ofron programe studimi për përgatitjen e infermierëve të përgjithshëm dhe infermierëve-mami me arsim të lartë. Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" synon fomimin e profesionistëve të aftë të praktikojnë teknologjinë infermierore në shëndetin e gruas. Programi synon të formojë specialistë të aftë për të vepruar si mami në sistemin spitalor dhe në konsultore por dhe si programues të politikave shëndetësore për gruan dhe administratorë. Programi është i hapur dhe për infermierë të përgjithshëm që synojnë të kompletojnë njohuritë e tyre në profimin Mami.<br>*(Evidencat I.1-Statuti i UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, I.3-Strategjia e zhvillimit të UGJ, I.6-Strategjia e zhvillimit të FSHN, I.9-Rregullore e programit të studimit)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, takimit në institucion dhe vizitës në ambientet e laboratorëve, GVJ konstaton se institucioni ka përvojë 11 vjeçare në ofrimin e këtij programi studimi. Në tabelat shoqëruese të RVB si dhe në CV e personelit akademik jepet një informacion i detajuar mbi numrin dhe cilësitë e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor "Infermieri-Mami". Nga verifikimi i të dhënave rezulton se në përgjithësi institucioni ka përvojë dhe kapacitete akademike për ofrimin e programit të studimit dhe bën përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e stafit. FSHN përgjegjës për programin e studimit Bachelor "Infermieri-Mami" ka tre departamente:<br>1. Dept. i Matematikës, Informatikës, Fizikës<br>2. Dept. i Shkencave Biologjike, Mjedisit dhe Ushqimit<br>3. Departamenti i Infermierisë<br>Në këtë fakultet aktivizohen një numër optimal personeli akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), si dhe personel ndihmës akademik (PNA), specialistë të fushave që mbulon secili departament:<br>1. Viti akademik 2022 – 2023<br>a. PAE 29, të kategorive:1 Prof., 9 Prof. Asc., 12 Dr., 7 Msc.<br>b. PAK 25, të kategorive: 2 Prof., 3 Dr., 20 Msc.<br>c. PNA 7<br>2. Viti akademik 2021 – 2022<br>a. PAE 30, të kategorive:1 Prof., 8 Prof. Asc., 11 Dr., 10 Msc.<br>b. PAK 25, të kategorive: 2 Prof., 2 Dr., 21 Msc.<br>c. PNA 9<br>3. Viti akademik 2020 – 2021 |

| | |
|---|---|
| | a. PAE 31, të kategorive:1 Prof., 7 Prof. Asc., 11 Dr., 12 Msc.<br>b. PAK 33, të kategorive: 2 Prof., 2 Dr., 29 Msc.<br>c. PNA 9<br>Departamenti i Infermierisë që ofron programin e studimit angazhon në mësimdhënie personel akademik me kualifikim kryesisht të fushës së mjekësisë dhe infermierisë të shpërndarë në vite si më poshtë.<br>1. Viti akademik 2022 – 2023<br>a. PAE 11, të kategorive: 2 Prof. Asc., 4 Dr., 1 Msc Ekz., 4 Msc.<br>b. PAK 8, të kategorive: 7 Msc, 1 Msc.-Spec.<br>c. PNA 2<br>2. Viti akademik 2021 – 2022<br>a. PAE 11, të kategorive:1 Prof. Asc., 3 Dr., 1 Msc.-Spec., 5 Msc.<br>b. PAK 8, të kategorive: 1 Dr., 2 Msc.-Spec., 5 Msc.<br>c. PNA 1<br>3. Viti akademik 2020 – 2021<br>a. PAE 10, të kategorive:1 Prof., 2 Dr., 6 Msc. (3 në proçes Dr)<br>b. PAK 11, të kategorive: 2 Dr., 1 Msc.-Spec., 9 Msc.<br>c. PNA 1<br>Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se pjesa më e madhe e stafit akademik PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program studimi i takon kategorisë Msc. Në diskutim me stafin akademik u informuam se me hapjen e proçedurave për ciklin e tretë të doktoraturës, një pjesë e stafit PAE ka aplikuar dhe është në pritje për t'u përfshirë në këto programe.<br>Institucioni ka kapacitetet e duhura infrastrukturore (laboratorë, mjete audiovizuale, auditorë) për zhvillimin e programit të studimit.<br>Institucioni ka marrëveshje aktive bashkëpunimi me Spitalin Rajonal "Omer Nishani" për realizimin e praktikave profesionale.<br>Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e bibliotekës që u vizituan nga GVJ.<br>*(Tabelat 1, 5, 6, 7, 16, 17 të RVB, Evidencat III.4-CV e personelit akademik, I.23-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ, I.28-Marrëveshje Bashkëpunimi, vizita dhe takimet në institucion)* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" ofrohet nga Departamenti i Infermierisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) të UGJ.<br>FSHN përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Infemierisë, Departamenti i Matematikës, Informatikës, Fizikës dhe Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisit dhe Ushqimit. Referuar tabelës 3 të RVBsë, FSHN në total ofron 9 programe të ciklit të parë (Bachelor) dhe të dytë (Master Profesional). Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" ofrohet nga Departamenti i Infermierisë që fokus akademik ka pregatitjen e studentëve në specialitetet e përgjithshme e specifike të shkencës infermieristike. |

| | |
|---|---|
| | Për vitin akademik 2022 – 2023 ky departament ofron 3 programe studimi:<br>a. Bachelor në "Infermieri përgjithshme"<br>b. Bachelor në "Infermier-Mami"<br>c. Master Profesional në "Shkenca Infermierore"<br>GVJ vlerëson se Programi Bachelor "Infermieri Mami" është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit duke respektuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi.<br>• Programi kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve<br>• Emërtimi përputhet me fushën specifike të studimit<br>• Strukturohet në 6 semestra akademikë (secili me 30 ECTS)<br>• Në ndarjen e lëndëve janë respektuar kriteret ligjore në fuqi (VKM 41 datë 24.01.2018)<br>Referuar RVB dhe evidencave shkresore të paraqitura GVJ konstatoi se institucioni ka përmbushur detyrimin për propozimin e kodifikimit kombëtar të programit të studimit Bachelor "Infermieri Mami" dhe është në pritje të aprovimit nga MASR.<br>*(Evidencat I.5-Rregullore e FSHN, I.6-Strategjia e zhvillimit të FSHN, I.9-Rregullore e programit të studimit, I.22 /I.22.1-Propozimi për kodifikimin e programeve të studimit të FSHN, tabela 3 e RVB)* |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon se programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit dhe në përputhje me fushën akademike të FSHN dhe Departamentit të Infermierisë që janë përgjegjës për këtë program studimi. Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" synon fomimin e profesionistëve të aftë të praktikojnë teknologjinë infermierore në shëndetin e gruas. Programi synon të formojë specialistë të aftë për të vepruar si mami në sistemin spitalor dhe në konsultore por dhe si programues të politikave shëndetësore për gruan dhe administratorë. Programi synon të pregatisë studentët me kapacitete të mjaftueshme teoriko-praktike për të vazhduar studime të mëtejshme dhe kërkim shkencor. Programi është në përputhje me strategjinë kombëtare në fushën e shëndetësisë dhe synon të përmbushë nevojat specifike për personel dhe kujdes infermieror/mami.*<br>*FSHN dhe Departamenti i Infermierisë kanë përvojë, kapacitete infrastrukturore të mjaftueshme për të realizuar këtë program studimi. FSHN ka kapacitete akademike dhe bashkëpunim me spitalin rajonal për realizimin e programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi I.2<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Për realizimin e programit të studimit Bachelor "Infermier-Mami" Departamenti i Infermierisë ka përfshirë PAE dhe PAK. Në realizimin e programit të studimit përfshihen dhe stafi ndihmës dhe administrativ i UGJ. Organizimi i strukturave realizuese të programit është piramidal dhe funksionon me parimin e bashkëpunimit dhe kontrollit.<br>GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit.<br>Në fillim të çdo viti akademik, dekanati koordinon orarin mësimor dhe ngarkesës mësimore të stafit akademik midis njësive bazë të FSHN si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi. Institucioni bën analizë të vazhdueshme të punës që pasqyrohet në Raportin vjetor të Departamenteve dhe raportin vjetor institucional. NJSBC jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit mbi aspekte të ndryshme të aktivitetit akademik. NJSBC është riorganizuar rishtas dhe ka pregatitur manualin e cilësisë. Ajo funksionon bazuar në rregullore dhe po pregatit për aplikim pyetsorët e rinj.<br>Në takimin me stafin, pedagogët referuan që janë të përfshirë në proçedurat vlerësuese e përmirësuese të syllabuseve.<br>*(Evidencat I.1-Statuti i UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, I.5-Rregullore e FSHN, I.7-Rregullore e Departamentit të Infermierisë, I.14/I.15/I.16-Organogramat e UGJ, FSHN dhe Departamentit të Infermierisë, I.11-Raporti vjetor UGJ, I.12-Raporti vjetor FSHN, I.13-Raporti i veprimtarisë mësimore Departamenti i Infermierisë, Takimi me stafin dhe NJSBC)* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Një nga prioritetet strategjike të përcaktuara në dokumentin për "Strategjinë e zhvillimit të UGJ 2020 – 2025" është rritja graduale e cilësisë dhe nivelit të punës shkencore si bashkëpunim me universitetet dhe qendrat kërkimore shkencore si dhe universitetet partnere. Ndërkombëtarizimi vlerësohet nga UGJ si një dimension prioritar i zhvillimit. Në këtë kuadër synohet zgjerimi dhe konkretizimi i marrdhënieve në të gjitha format e bashkëpunimit ndërkombëtar me IAL dhe institucione të tjera kërkimore-shkencore në funksion të pjesmarrjes aktive në projekte të përbashkëta, realizimin e programeve të përbashkëta, nxitjen e shkëmbimit të stafit akademik e ndihmësakademik etj. |

| | |
|---|---|
| | Për realizimin e objektivave të proçesit mësimor e formues UGJ ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda dhe jashtë vendit si dhe me institucione spitalore. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh për mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus+. Në analizën vjetore institucionale janë paraqitur në mënyrë të detajuar marrëveshjet, mobiliteti i stafit dhe studentëve si dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të marrëveshjeve.<br>***Në takimin me stafin u njohëm me faktin se numri i bashkëpunimeve të Departamentit të Infermierisë është i ulët.*** Megjithatë ka një shtim të aplikimeve për projekte sidomos nga pedagogët e rinj me ambicie për të zhvilluar kërkim shkencor dhe karrierë akademike. Institucioni mbështet pedagogët në pregatitjen e dokumentacionit dhe proçedurën e aplikimit.<br>*(Evidencat I.3-Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem çabej", Gjirokaster 2020 – 2025, I.3.2-Strategjia e ndërkombëtarizimit, Tabela 5 e RVB, Evidencat I.23/I.24/I.25-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ, Lista e projekteve, Lista e mobiliteteve, I.11-Raporti vjetor UGJ, Takimet në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Programi Bachelor "Infermier-Mami" është një program i gjerë, i dedikuar i kujdesit shëndetësor që pais studentin me aftësi për ndërhyrje terapeutike, rehabilituese e parandaluese në fusha të ndryshme të asistencës mjekësore si infermieristikë e përgjithshme, infermieristikë kirurgjikale dhe e urgjencës, si dhe me njohuri më të plota e specifike në obstetrikë-gjinekologji. Në funksion të realizimit të praktikës shumëplanëshe në funksion të programit institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Rajonal "Omer Nishani", Gjirokastër. Praktikat spitalore mbikqyren nga personel infermier dhe/ose mami. ***GVJ rekomandon rivendosjen e marrëveshjeve me Drejtorinë rajonale të shëndetësisë si dhe me qendra konsultore e poliklinike për të siguruar praktikë profesionale në të gjitha fushat e ekspertizës që janë qëllim i programit të studimit Bachelor "Infermier-Mami".***<br>*(Tabela 5 e RVB, Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, I.28-Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet UGJ dhe Drejtorisë së Spitalit Rajonal "Omer Nishani", Takimet në institucion)* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse e programit të studimit harton raporte analitike për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkim shkencor, mobilitet etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. |

| | |
|---|---|
| | *(Evidencat I.13/I.13.1/I.13.2-Raportet e veprimtarisë mësimore Departamenti i Infermierisë, tabelat 19, 20 të RVB)* |
| **Konkluzione** | *UGJ ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shëndetësore lokale përmes të cilave siguron realizimin e praktikave klinike për studentët e këtij programi studimi me qëllim pregatitjen e specialistëve në fushën e infermieristikës dhe të mamisë të aftë për të shërbyer në komunitet në parandalim, kurim edukim shëndetësor etj.*<br>*UGJ ka lidhur një numër të madh marrëveshjes me institucione universitare europiane që i shërbejnë jo vetëm aftësimit profesional të stafit por janë dhe në funksion të kërkimit shkencor dhe mobilitetit.*<br>*GVJ rekomandon shtimin e marrëveshjeve specifike për këtë program studimi me njësi të ofrimit të shërbimit shëndetësor primar dhe me konsultore të nënës dhe fëmijës. GVJ rekomandon shtimin e bashkëpunimeve internacionale të stafit të Departamentit të Infermierisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit.<br>Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe RVB:<br>• Programi Bachelor "Infermier-Mami" është program i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.<br>• Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kritereve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 datë 24.01.2018. |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<ul>
<li>Programi organizohet në formën e studimit me kohë të plotë.</li>
<li>Kohëzgjatja e studimeve është 3 vite akademike/6 semestra.</li>
<li>Vlerësimi në kredite: 180 ECTS (4500 orë) të ndara 60 ECTS për vit akademik (1500 orë).</li>
<li>1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit.</li>
<li>Raporti ECTS:orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 10 – 12/15 – 13 orë në auditor/orë studimi individual. Për praktikën profesionale 1 ECTS=25). Provimi përfundimtar llogaritet 5.5 ECTS ose 137.5 orë studimi individual.</li>
<li>Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta.</li>
<li>Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module të prezantuara në planin mësimor dhe tabelat e RVB.</li>
<li>Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimit teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (praktikë profesionale). Referuar llogaritjeve në planin mësimor, orët totale janë 4500</li>
</ul>
<table>
<tr><th>Bsc “Infermieri Mami”</th><th>Në total</th></tr>
<tr><td>Në auditor</td><td></td></tr>
<tr><td>- Leksione</td><td>1155.5</td></tr>
<tr><td>- Seminare</td><td>320.5</td></tr>
<tr><td>- Praktika profesionale</td><td>500</td></tr>
<tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td>2524</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>4500</td></tr>
</table>
<ul>
<li>Frekuentimi i orëve është i detyrueshëm në masën 75 – 80% për orët e seminareve. Leksionet janë fakultative por ndjekja e tyre është e rekomanduar.</li>
<li>Çdo semestër ka 15 javë mësim dhe 3 – 4 javë sezon provimi.</li>
<li>Programi i studimit mbyllet me provim ose temë diplome. Sipas rregullores së programit të studimit, ka të drejtë të diplomohet duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome, studenti i cili e ka mesataren e ponderuar të dy viteve të para të studimit më të lartë se 8 ose një kufi më i lartë i përcaktuar nga njësia bazë.</li>
</ul>
(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.8/II.9-Plani mësimor i programit të studimit, II.28-Syllabuset, Tabelat 9, 10, 12 të RVB)
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të</td>
<td>Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë të aftë për të ofruar shërbim me një nivel të lartë profesional në fushën Infermier-Mami duke përdorur sistemet e reja të teknologjisë infermierore. Programi synon t’i paisë studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës.<br>Programi i studimit Bachelor “Infermier-Mami” realizohet në 27 lëndë/module të cilat ofrojnë informacion teoriko-praktik të gjerë në fushën e infermierisë dhe mamisë. Lëndët e formimit bazë mjekësor</td>
</tr>
</table>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | (anatomi, fiziologji, biokimi mjekësore, shkenca biomedikale) dhe formimit të përgjithshëm (shkenca sociale dhe të shëndetit, gjuhë e huaj, informatikë dhe statistikë mjekësore) janë pjesë e programit në vitin e parë të studimit. Në vitin e parë studenti merr njohuri dhe për bazat e infermieristikës dhe puerikulturën. Në dy vitet e tjera, programi synon aftësimin teoriko-praktik të studentëve në fushat e gjera të aplikimit të kujdesit infermieror si kirurgji dhe urgjencë mjekësore, pediatri, patologji e përgjithshme, anatomi patologjike dhe farmakologji. Në vitin e dytë e veçanërisht në vitin e tretë programi përmban një numër të madh lëndësh të fokusuar në shërbimin infermieror në fushën e obstetrikë gjinekologjisë. Lëndët me zgjedhje (psikologji mjekësore dhe shëndet mjedisor në vitin e parë, dietologji e menaxhim projektesh në vitin e dytë, fizioterapi e radiologji në vitin e tretë) zgjerojnë fokusin e interesit në fusha specifike të ofrimit të shërbimit dhe administrimit spitalor.<br>Një vend të rëndësishëm në programin mësimor zë praktika profesionale e cila i krijon mundësi studentit të ballafaqojë njohuritë e marra në auditor me realitetin praktik diagnostik. Programi ka si mision të prezantojë studentët me aktivitete direkte në rastet e parandalimit, kurimit, rehabilitimit dhe proçedurave të vlerësimeve funksionale.<br>Programi në tërësi (vlerësuar nga analiza e syllabuseve të lëndëve) jep njohuri të përparuara në fushën e studimit dhe pregatit specialistë që konkurojnë denjësisht në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar.<br>Ndërthurja e koncepteve teorike me praktikën profesionale zhvillon tek studentët aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse kryesisht në fushën e mamisë. Studentët që diplomohen në këtë program studimi janë të aftë të punojnë në konsultore, dhe në shërbimet spitalore në sektorin e obstetrikë-gjinekologjisë.<br>Formimi i përgjithshëm dhe aftësimi profesional krijon premisa edhe për profilizim profesional në fusha më specifike si dhe thellimin e studimeve në Master Profesional dhe/ose Shkencor.<br>*(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.8/II.9-Plani mësimor i programit të studimit, II.28-Syllabuset, Tabelat 9, 10, 12 të RVB)* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Referuar tabelës 9 të RVB dhe programit të studimit Bachelor "Infermier-Mami" për vitin 2022 – 2023, GVJ vlerëson se programi përmban të gjithë elementët sipas strukturës së përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Sipas planit mësimor, programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:<br>• Kategoria A: Lëndë bazë 34 ECTS ose 18.9% (standardi 15 – 20%)<br>• Kategoria B: Lëndë karakterizuese 90 ECTS ose 50% (standardi 50 – 55%) |

| | |
|---|---|
| | • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 23 ECTS ose 12.8% (standardi 12 – 15%)<br>• Kategoria D: Lëndë plotësuese 27.5 ECTS ose 15.3% (standardi 10 – 15%)<br>• Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 5.5 ECTS ose 3% (standardi 3 – 5%)<br>GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese ka përmirësim nga viti 2021 – 2022 (të dhënat e këtij viti janë përmbledhur në RVB dhe kanë shmangie nga kërkesat për kategorinë E, detyrimet përmbyllëse) dhe është në përputhje me Tabelën 1 të Shtojcës 1 të VKM Nr.41.<br>*(Evidencat II.8/II.9-Plani mësimor i programit të studimit, II.28-Syllabuset, Tabelat 9, 10 të RVB)* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Në planin mësimor verifikojmë se praktika profesionale, e quajtur "Praktikë Infermierore" ka 20 ECTS dhe realizohet:<br>• Në vitin e dytë, semestrin e dytë 10 ECTS<br>• Në vitin e tretë, semestrin e dytë 10 ECTS<br>Në nenin 11 të kreut III të rregullores së programit të studimit përcaktohen qartë kushtet e diplomimit, mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm si dhe mënyra e organizimit të mbrojtjes së temës së diplomës. Në planin mësimor përcaktohen 5.5 ECTS për detyrimet përmbyllëse.<br>*(Evidencat II.8/II.9-Plani mësimor i programit të studimit, II.28-Syllabuset, Tabelat 9, 10 të RVB)* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Në statutin e UGJ përcaktohet qartë që pranimi dhe regjistrimi i studentëve në të gjitha programet e studimit bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Pranimet bëhen me vendim të senatit akademik në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore. Në statut theksohet se standardet verifikohen dhe çertifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. GVJ përmes shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni u njoh me praktikën e ndjekur për verifikimin e kapaciteteve pritëse, kuotat e propozuara dhe kriteret e pranimit të studentëve.<br>Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloret e programeve të studimit përcaktohet forma e organizimit të studimeve. Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" është program studimi i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Ai zhvillohet me kohë të plotë dhe në përputhje me gjithë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.<br>UGJ aplikon sistem financimi për studentë të kategorive të veçanta dhe studentët e ekselencës mbështetur dhe në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe VKM 780, datë 26.12.2018. Në takimin me studentët u |

| | |
|---|---|
| | informuam që institucioni ka aplikuar në këtë program studimi bursa me karakter social por dhe bursa për studentët e ekselencës. GVJ u njoh me vendimet e bordit të administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta.<br>*(Evidencat I.1-Statuti i UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, I.9-Rregullore e programit të studimit, II.10/II.11/II.12/II.13-Raporte të verifikimit të kapaciteteve pritëse dhe kuotat për vitet 2020 – 2021, 2021 – 2022, 2022 – 2023, II.14- Vendimet e bordit të administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta)* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Në RVB theksohet se programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" në UGJ ka një ngjashmëri në përmbajtje deri në masën 70% me program të të njëjtës fushë të ofruara nga universitetet publike në Shqipëri. Në takimin me drejtuesit e institucionit GVJ u informuam se programi i studimit krijon mundësi për mobilitet në programe të ngjashme në fushën e mamisë si dhe në infermieri. Programi i studimit i jep studentëve një pregatitje të qëndrueshme për të ndjekur dhe ciklin e dytë të studimeve në fushën e mamisë por dhe në fushën e infermierisë.<br>***GVJ sugjeroi ndryshimin në të ardhmen dhe fokusin specifik të titullit të diplomës në Mami referuar dhe faktit që studentët e diplomuar në këtë program studimi liçensohen në profesionin "Mami". Drejtuesit e institucionit e mbështetën titullimin e diplomës me nevojat e tregut lokal (ka zona ku vetëm një person duhet të ofrojë dhe shërbim infermieror dhe mami.)***<br>*(RVB, Takimi me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë të programit të studimit)* |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Departamenti i Infermierisë dhe FSHN kanë propozuar kodifikimin e programit të studimit Bachelor "Infermier-Mami". Propozimi i është dërguar Rektorit me shkresë Nr. 17/8 datë 28.02.2023. Propozimet për kodifikimin e programeve të FSHN janë dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve me shkresën e rektorit Nr. 343 datë 16.03.2023. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se UGJ është në pritje të përgjigjes për kodifikimin e programit të studimit nga ministria përkatëse dhe pas ardhjes së përgjigjes do të proçedohet me kodifikimin e lëndëve të programit të studimit.<br>*(Evidencat I.22-Përciellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve, I.22.1-Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të FSHN)* |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në | Kriteri nuk aplikohet. Programi i studimit nuk ofrohet si program i përbashkët. |

| | |
|---|---|
| përputhje me legjislacionin në fuqi. | |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të ofruar shërbim me një nivel të lartë profesional në fushën Infermier-Mami duke përdorur sistemet e reja të teknologjisë infermierore. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Pranimi, regjistrimi i studentëve dhe financimi në programet e studimit të UGJ bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati. Programi krijon mundësi për mobilitet dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë. Institucioni ka aplikuar për kodifikimin e programit të studimit dhe është në pritje të përgjigjes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës në UGJ që ofron programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.<br>UGJ është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në qytetin e Gjirokastrës. Institucioni përbëhet nga organet akademike që janë senati akademik, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme dhe autoritet akademike (rektori, dekanët, drejtuesit e njësisë bazë); organe administrative që janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësive kryesore; organe kolegjiale që janë këshilli i rektoratit, këshilli i dekanatit, këshilli etikës. UGJ ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar me vendim të BA nr.55, datë 16.12.2021, për një periudhë katër vjeçare. Programet e studimit që ofron institucioni janë në proçes akreditimi. |

Fakulteti i Shkencave të Natyrës në UGJ që ofron programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Ky fakultet është hapur me VKM Nr. 414 datë 12.11.1991 dhe përbëhet nga tre Departamente si më poshtë:

- Departamenti i Infermierisë
- Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisit dhe Ushqimit
- Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Infermierisë. Referuar tabelave 1 dhe 2 të RVB, në vitin akademik 2022 – 2023, njësia bazë përbëhet nga ***11 anëtarë PAE*** dhe përfshin në mësimdhënie dhe ***8 anëtarë PAK***. Kualifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie është:

| PAE | PAK |
|---|---|
| **Tituj/Grada** | **Tituj/Grada** |
| (2) Prof. Asc.<br>(4) Dr.<br>(1) Msc.Ekz.<br>(4) Msc. | (1) Specializim afatgjatë<br>(7) Msc. |

Referuar të dhënave të tabelave 1 dhe 2 vërehet përmirësim i cilësisë së stafit akademik në tituj dhe grada (detajuar në Standardin I.1, kriteri 4). Në programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" janë përfshirë 17 personel akademik prej të cilëve:

- 11 PAE (2 Prof. Asc., 4 Dr., 1 Msc.Ekz. , 4 Msc. nga të cilët ,1 Dr. në proçes)
- 7 PAK (1 specializim afatgjatë, 6. Msc.)

Lidhur me treguesit e moshës pjesën më e madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie që kanë tituj akademikë dhe gradë shkencore doktor i përkasin grup moshës relativisht të re 35-55 vjeç. Nga analiza e tabelave mbi shperndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezulton se rreth 80% e ngarkesës përballohet nga PAE.

***Në raport me stafin akademik GVJ vëren se:***

1. ***Si titullarë lënde dhe për realizimin e lëndëve specifike të fushës së obstetrikë gjinekologjisë nuk ka asnjë anëtar PAE me diplomë mjek specialist në obstetrikë-gjinekologji apo Master Shkencor në Mami.***
2. ***Pedagogu i diplomuar në shëndet publik jep lëndë mjekësore të profileve specifike si radiologji, fizioterapi, shtatzani dhe lindje normale, patologji të përgjithshme dhe praktikë infermierore pa patur asnjë kompetencë profesionale për realizimin e tyre. Kjo natyrisht cënon rëndë cilësinë e mësimdhënies.***

***GVJ rekomandon rishikimin e stafit dhe plotësimin e tij me personel efektiv ose me kontrate, me kompetencë profesionale për lëndët e obstetrikë gjinekologjisë.***

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43 123
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | *(Evidencat I.1"Statuti i UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, I.5-rregullore e FSHN, I.15/I.16-Organiogramat e FSHN dhe Departamentit të Infermierisë, I.19-Vendim për hapjen e FSHN, I.20, I.21-vendimi i Akreditimit institucional periodik, Tabelat 1, 2, 4, 6, 7, 8 të RVB, CV e stafit akademik)* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | FSHN dhe Departamenti i Infermierisë kanë angazhuar në këtë program studimi dhe 2 staf ndihmës akademik që asiston studentët në realizimin e punëve laboratorike në mjediset e institucionit.<br>Në funksion të programit të studimit janë dhe personeli administrativ dhe ndihmës teknik. Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe teknik dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione punë.<br>*(Tabelat e RVB, takimet në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Departamenti i Infermierisë është përgjegjës për tre programe studimi, dy programe Bachelor dhe një program Master Profesional. Ky department funksionon në bazë të grupeve mësimore – kërkimore (paraklinik dhe klinik) drejtuesit e të cilit analizojnë në mënyrë periodike zhvillimin e proçesit mësimor, të praktikës profesionale, aktivitetin kualifikues të stafit dhe punën kërkimore-shkencore. Analiza nuk bëhet për program studimi por për grup pedagogësh dhe lëndësh. Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit mësimor-shkencor me kohë të plotë në mësimdhënie, aktivitet shkencordhe mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.<br>***Pavarësisht analizës së grupeve mësimore, GVJ mendon se programi i studimit ka nevojë për një analizë të integruar të të gjithë elementëve të tij, ka nevojë për koordinim të veprimtarive në auditor dhe veprimtarive praktike, ka nevojë për monitorim dhe identifikim të problematikave, raportim të tyre dhe pregatitjen e strategjive zhvilluese.***<br>***GVJ rekomandon emërimin e koordinatorit për programin e studimit nga përgjegjësi i departamentit. Koordinatori duhet të jetë staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion për programin specific Bachelor "Infermier-Mami".***<br>*(Evidencat II.27/II.27.1-Raportet vjetore të grupeve mësimore-kërkimore, Takimet në institucion)* |
| **Konkluzione** | *UGJ, FSHN dhe Departamenti i Infermierisë që ofrojnë programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" përmbushin përgjithësisht kërkesat ligjore dhe standartet e cilësisë për ofrimin e tij. Stafi akademik përbëhet nga një numër optimal pedagogësh PAE dhe PAK, me moshë relativisht të, re me grada e tituj ose në proçes për marrjen* |

| | |
|---|---|
| | *e tyre. Në funksion të programit të studimit institucioni ka angazhuar dhe personel ndihmës akademik, personelin administrativ dhe ndihmës.* ***GVJ vëren se në disa raste personeli akademik përfshihet në mësimdhënie për lëndë për të cilat nuk ka kompetencë profesionale. Mungojnë lektorët me formim në obstetrikë-gjinekologji.*** *Departamenti e fokuson analizën e punës mësimore-kërkimore në mnëyrë globale të ndarë sipas grupeve mësimore-kërkimore.* ***GVJ sugjeron që në mbështetje të kërkesave të standardit, departamenti duhet të caktojë një koordinator përgjegjës për programin e studimit që veç të tjerash duhet të sigurojë lidhjen dhe shpërndarjen harmonike të studentëve në institucionet e kryerjes së praktikës.*** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | FSHN dhe Departamenti i Infermierisë në UGJ që ofrojnë programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" disponojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.<br>Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion kemi gjetur informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, të dhëna për infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementin i diplomës.<br>Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin ketë program studimi.<br>Në takimin me stafin dhe drejtuesit e institucionit u informuam për përfshirjen aktive të stafit në pregatitjen e RVB dhe hartimin e dokumentacionit bazë dhe mbështetës për proçesin e akreditimit.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.5-Rregullore e FSHN, I.9- Rregullore e programit të studimit, II.9.1- Plani mësimor, II.28- Syllabuset e lëndëve)* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" përmban planin mësimor me të gjithë informacionin e nevojshëm për lëndët dhe organizimin e tyre. Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore). Për secilën lëndë jepet informacion i |

| | |
|---|---|
| ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | detajuar për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual. Jepet gjithashtu informacion për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte dhe praktika.<br>***GVJ sugjeron rishikimin e raporteve leksion/seminar për lëndët infermierore duke shtuar seancat e laboratoreve që janë seanca të mësimit praktik në auditor për të shtuar shprehitë praktike të domosdoshme në fushën aplikative të programit të studimit. Kjo ishte dhe kërkesë e studentëve e shprehur prej tyre në takimin me GVJ.***<br>*(Tabelat 9, 10 të RVB, Evidencat II.8/II.9.1-Plani mësimor, takimi me studentët në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Në takimet me sekretarinë mësimore dhe studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. GVJ konsultoi dokumenta të dosjes dhe dokumentacione të sekretarisë mbi proçedurën e transferimit të studentëve.<br>Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimit që vendosen me VKM dhe rregulloren e UGJ. Departamenti i Infermierisë në FSHN propozon kriteret dhe kuotat e pranimit, kuotat e transferimit etj. mbështetur në kapacitetet pritëse dhe akademike të cilat miratohen nga senati akademik dhe dërgohen në QSHA.<br>Institucioni nxjerr njoftime për pranimin ku përshkruhet proçedura e aplikimit, testimit, shpalljes së fituesve dhe regjistrimit.<br>Në Kreun VI të rregullores së studimeve të UGJ përcaktohet qartë mënyra e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Informacioni përcillet dhe nga Rregullorja e FSHN dhe Rregullorja e programit të studimit.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.5-Rregullore e FSHN, I.9- Rregullore e programit të studimit, II.20-Proçedurë e transferimit të studentëve, II.10/II.11/II.12/II.13-Raporte të verifikimit të kapaciteteve pritëse dhe kuotat për vitet 2020 – 2021, 2021 – 2022, 2022 – 2023, Takimet në institucion)* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë dhe për praktikën profesionale. Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".<br>***GVJ konstatoi se:***<br>• ***një pjesë e syllabuseve nuk janë të firmosur nga titullari i lëndës***<br>• ***disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Ka titullarë lënde dhe lektorë të kategorisë Msc.***<br>• ***Disa prej titullarëve japin lëndë jashtë profilit të formimit të tyre profesional.*** |

| | |
|---|---|
| | ***GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe lektorëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre dhe formimit profesional sipas kërkesave ligjore.***<br>Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar.<br>***GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar dhe ndihmëse.***<br>*(Evidencat II.9.1- Plani mësimor, II.28-Syllabuset e lëndëve)* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | GVJ konstaton se programet e studimit në UGJ janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Programi Bachelor "Infermier-Mami" është riorganizuar në tërësi sipas kërkesave të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në departament çdo fillim viti. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse të mundësuara dhe nga investimet në mjete audiovizive në auditorë si dhe investimet në laboratorë.<br>*(Evidencat II.7/II.7.1/II.7.2/II.7.3-Praktika e ndjekur për riorganizimin e planeve mësimore 2018 – 2019, II.9-Vendim i senatit akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021 – 2022, takimi me stafin në institucion)* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.*<br>*Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".*<br>*Përmbajtja e programit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.*<br>***GVJ konstaton se disa nga titullarët e lëndëve dhe lektorët nuk plotësojnë kushtet e kualifikimit (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë) si dhe në disa lëndë vërehet mospërputhje me fushën profesionale të lektorit.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës në rajonin jugor të Shqipërisë si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun universitar rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale. Në hartimin e programit të studimit janë respektuar kërkesat ligjore për raportet e veprimtarive formuese (lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese, detyrime përmbyllëse).<br>Veçori e këtij programi është pregatitja e gjërë në mami por dhe një pregatitje bazë në infermieri që i krijon mundësi punësimi dhe kualifikimi të mëtejshëm studentëve në të dy degët si dhe dhënien e kontributit profesional për të dy specialitetet në zona ku tregu i punës e kërkon.<br>***GVJ rekomandoi ndryshimin në të ardhmen dhe fokusin specifik të titullit të diplomës në Mami referuar dhe faktit që studentët e diplomuar në këtë program studimi liçensohen në profesionin "Mami".***<br>*(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.9.1-Plani mësimor)* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Programi ka një shpërndarje të llogjikshme të lëndëve në vite dhe semestra si dhe vlerësim në kredite sipas rëndësisë së syllabusit në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.<br>Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës në orë mësimore /ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme.<br>Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën studimit Bachelor "Infermier-Mami". Studentët marrin një formim të gjerë për kujdesin infermieror në shumë specialitete si kirurgji, sëmundje të brendshme, pediatri, urgjencë mjekësore, por marrin dhe një formim më të thelluar për kujdesin infermieror në obstetrikë gjinekologji.<br>*(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.9.1-Plani mësimor)* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori | Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën 12 vjeçare të ofrimit të këtij programi nga UGJ si dhe |

| | |
|---|---|
| praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | mbështetur në modelet dhe praktikat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë.<br>Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë në përgjithësi janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. 1 ECTS llogaritet 25 orë prej të cilave 12 – 15 janë orë në auditor (leksion, seminar) dhe 13 – 10 janë orë të pregatitjes individuale. Diferencat lidhen me tipologjinë e lëndës. Struktura e ngjashme e programit (sipas referimit të pedagogëve) dhe shpërndarja proporcionale e ECTS-ve në semestra, 30 ECTS me një total prej 180 ECTS mundëson transferimin dhe ekuivalentimin e programit.<br>Në takimet me zyrën e këshillimit të karrierës GVJ u informua se nuk ka informacione për transferim kreditesh nga studentët e këtij programi studimi. Ajo që evidentohet është kërkesa e të diplomuarve për suplementin e diplomës pasi një pjesë prej tyre projektojnë të vazhdojnë aktivitetin profesional apo shkollimin jashtë vendit.<br>***GVJ mbështet kërkesën e studentëve për rishikimin e shpërndarjes së orëve në auditor (shih standardi II.3, kriteri 2). Në takimin me titullarët e institucionit dhe stafin akademik GVJ vuri në dukje dhe diskutoi mungesën e marrëveshjeve me qëndra konsultore apo me qëndrat shëndetësore për realizimin e praktikave jospitalore për monitorimin e shtatzanisë. U evidentua gjithashtu fakti që mungon një rregullore e praktikave profesionale (mënyra e organizimit, mbikqyrjes dhe vlerësimit të njohurive të marra) e veçantë ose e integruar në rregulloren e programit të studimit. GVJ sugjeroi shtimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësi të ofrimit të kujdesit shëndetësor primar për gruan shtatzanë dhe hartimin e rregullores.***<br>*(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.9.1-Plani mësimor Takimet në institucion)* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Strukturimi i programit, unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurues në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.<br>Në takimet me studentët, NJSBC dhe Zyrën e këshillimit të karrierës u informuam se pjesa më e madhe e studentëve që mbarojnë këtë program studimi ndjekin në vijim studimet Msc në Mami ose Msc në Infermieri. Tregu lokal i punës tërheq një pjesë të studentëve.<br>Në takimin me studentët u theksua se në vitet e fundit është shtuar kërkesa për tërheqje të suplementit të diplomës me qëllim ekuivalentimin e programit në institucione punësimi jashtë vendit. Ka një ulje të kërkesave të tregut lokal referuar dhe riorganizimit të sistemit të ofrimit të kujdesit shëndetësor.<br>*(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.9.1-Plani mësimor, II.19-Të dhëna statistikore nga zyra e alumni, Takimi me zyrën e këshillimit të karrierës dhe alumni, NJSBC, Studentët)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Institucioni inkurajon përditësimin e vazhdueshëm të programit të lëndëve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Në syllabuse është punuar për përditësimin e literaturës së huaj. Mbështetur në literaturë bashkëkohore, pedagogët e këtij programi studimi pregatisin leksione dhe materiale didaktike të shkruara për studentët. Këto materiale janë përdorur me efiçiencë veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë dhe mësimit on line. Pedagogët e këtij programi studimi janë eshe autorë librash për studentët. *(Evidencat II.28-Syllabuset e lëndëve, II.22-Miratimi i literaturës bazë në DIF 2020 – 2021)* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi është konceptuar dhe organizuar me njohuri teorike që rrjedhin nga shkencat bazë të mjekësisë të cilat trajtohen në aspektin aplikativ duke krijuar një bazë formuese për të vlerësuar me një sy klinik situatat e paraqitura.<br>Referuar rregullores së programit të studimit të diplomuarit në Infemier-Mami mund të punojnë në këtë pozicion në një gamë të gjerë organizmash shëndetësore. Programi synon veç të tjerash të formojë prakticienë reflektues që kanë aftësi të punojnë në grup. Programi synon të paisë studentët me aftësitë themelore në teknologjinë infermierore, të aftë të sintetizojnë eksperiencat, të gjenerojnë ide, të mendojnë në mënyrë krijuese, të komunikojnë në mënyrë efektive.<br>GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit garanton përmbushjen e këtyre objektivave dhe përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën studimit Bachelor "Infermier-Mami". Strukturimi i programit krijon mundësi për transferim të studimeve dhe mobilitet.<br>*(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.9.1-Plani mësimor, II.28-Syllabuset e lëndëve)* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | UGJ mban kontakte më urdhërin e infermierit në Shqipëri institucionet mjekësore e universitare brenda e jashtë vendit. Kontaktet me partnerët përditësojnë informacionin mbi kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" është i strukturuar për të pregatitur specialist Infermierë-Mami me aftësi profesionale në përputhje me tregun e punës si dhe me pregatitje teoriko praktike të përshtatshme për vijimin e studimeve të thelluara Master në të njëjtën fushë. Në takimet me stafin dhe GVJ u informuam se zgjedhjet kryesore të studentëve janë vijimi i studimeve Master Profesional ose largimi jashtë vendit për shkollim ose punësim.<br>*(Evidencat II.18-Database Alumni, II.19-Të dhëna statistikore nga zyra e alumni, Takimet në institucion)* |
| **Konkluzione** | *Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit Bachelor "Infermier-Mami" synon* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.* ***GVJ sugjeroi shtimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësi të ofrimit të kujdesit shëndetësor primar për gruan shtatzanë dhe hartimin e rregullores.*** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Në dokumentin e strategjisë përcaktohet qartë se FSHN ka si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e programeve të studimit që ofron si dhe pasurimin e kurrikulës universitare me programe të reja studimi të ciklit të dytë e të tretë si dhe programe profesionale. FSHN synon të kthehet në një qendër të edukimit të vazhdueshëm në rajonin e jugut, një qëndër e arsimit dhe kërkimit shkencor të orientuar nga tregu i punës, reformat social-ekonomike dhe standardet e integrimit europian.<br>Për të arritur këtë qëllim FSHN është fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës, kualifikimin e burimeve njerëzore si dhe në politikat mbeshtetëse për studentët dhe personelin e fakultetit. Në takimet me drejtuesit e institucionit dhe personelin akademik GVJ u informua se përmes analizave dhe debatit shkencor në nivel Departamenti dhe Fakulteti diskutohen dhe aplikohen ndryshimet përmirësuese të programeve me kontributin e pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie. Mobiliteti dhe pjesmarrja në projekte ka bërë që stafi akademik të njihet dhe të aplikojë më mirë programe bashkëkohore që përshtasin programet aktuale me kërkesat e tregut të punës dhe me kërkesat e kartës së Bolonjës.<br>***Në dokumentacion nuk ka një analizë të mirëfilltë të tregut të punës, por në takimet me drejtuesit, stafin dhe GVB u informuam se shtysë për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit janë dhe takimet e organizuara me organizata partnere apo aktorë të tregut të punës në kuadër të panairit "Ëork and study".***<br>Në takimet me studentët dhe përfaqësuesit e zyrës së këshillimit të karrierës u informuam se studentët e programeve të studimit Bachelor në Infermieri apo Infermieri-Mami në përgjithësi vazhdojnë shkollimin në programet Master. Kjo evidentohet dhe në tabelën 23 të RVB ku vihet re një diferencë e rëndësishme midis numrit të të diplomuarve në |

| | |
|---|---|
| | periudhën 2020 – 2023 (21) dhe numrit të të punësuarve nga ky kontigjent i diplomuar (5)<br>*(Evidencat I.6-Strategjia e FSHN, I.13-Analiza vjetore e Departamentit të Infermierisë, II.15-Pjesmarrje në panairin Ëork and Study, takimet në institucion, tabela 23 e RVB)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Në parim UGJ nxit dhe përfshin në diskutime studentët të cilët janë të përfaqësuar në senatin akademik dhe NJSBC. Studentët kanë gjithashtu organizimin e tyre në formën e Këshillit studentor.<br>***Megjithatë, në programin e studimit Bachelor në Infermieri Mami studentët rezultojnë pak të përfshirë në proçesin e përmirësimit të programit të studimit. Në takimet me drejtuesit e institucionit dhe stafit akademik u njohëm me faktin që studentët e këtij programi në përgjithësi kanë mesatare të ulët.***<br>Zyra e Këshillimit të karrierës dhe Alumni mban kontakte me studentët e diplomuar edhe në funksion të përmirësimit të programeve të studimit.<br>*(Evidencat II.1.1-Lista e anëtarëve të senatit akademik, II.25/II.26-Këshilli studentor, takimet në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin rajonal "Omer Nushani" si dhe me institucione homologe brenda dhe jashtë Shqipërisë. Institucioni bashkëpunon me urdhërin e infermierëve të Shqipërisë dhe aktorë të tjerë përmes panaireve dhe aktiviteteve të përbashkëta. Këmbimi i eksperiencave ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor "Infermier-Mami".<br>***(Evidenca I.23-Marrëveshjet e Bashkëpunimit)*** |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka krijuar kushte për përmirësim dhe përditësim të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e kohës. Në parim UGJ nxit dhe përfshin në diskutime studentët të cilët janë të përfaqësuar në senatin akademik dhe NJSBC. Studentët kanë gjithashtu organizimin e tyre në formën e Këshillit studentor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi III.1<br>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</td><td>Për zhvillimin e proçesit mësimor institucioni/programi i studimit ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, laboratorë, praktika profesionale e klinike, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshop.<br>Departamenti i Infermieristikës në parim inkurajon përfshirjen e studentëve të programeve Bachelor në punimet shkencore të pedagogëve apo në projekte shkencore në rang Departamenti e Fakulteti megjithatë në tre vitet e fundit asnjë student i programit Bachelor Infermier-Mami nuk është aktivizuar në aktivitete të departamentit.<br><br>Në organizimin e studimeve një vend të rëndësishëm zë dhe puna e pavarur e studentit (56% e orëve totale).<br>Tabela e mëposhtme paraqet informacion më të detajuar të përmbledhur nga tabela e planit mësimor në RVB. Diploma në total ka 137.5 orë të cilat janë orë studimi individual.
<table>
<tr><th>Bsc “Infermieri Mami”</th><th>Viti I</th><th>Viti II</th><th>Viti III</th><th>Në total</th></tr>
<tr><td>Në auditor</td><td></td><td></td><td></td><td>1976 (44%)</td></tr>
<tr><td>- Leksione</td><td>435.5</td><td>365</td><td>355</td><td>1155.5</td></tr>
<tr><td>- Seminare</td><td>183.5</td><td>85</td><td>52</td><td>320.5</td></tr>
<tr><td>- Praktika profesionale</td><td>-</td><td>250</td><td>250</td><td>500</td></tr>
<tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td></td><td></td><td></td><td>2524 (56%)</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td></td><td></td><td></td><td>4500</td></tr>
</table>
<br>(Evidencat II.9.1-Plani mësimor, II.28-Syllabuset e lëndëve, tabelat e RVB)</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</td><td>Në takimet në institucion me personelin akademik dhe me studentët GVJ u informua se personeli akademik ka përvojë dhe ofron për studentët mënyra e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me nevojat e tyre. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda të tilla si prezantime në ppt., video, biseda interaktive me studentët, demostrimi i proçedurave praktike laboratorike me mulazhe, ushtrime me raste klinike etj. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | gjatë zhvillimit të mësimit teorik, laboratorëve mësimore apo praktikave profesionale ku synohet pjesmarrje aktive në proçedura praktike infermierore. Në takimin me stafin akademik GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit; stimulohet mësimi interaktiv që kombinon shpjegimin me pyetjet për subjektin e shpjeguar apo ushtrimet në lidhje me të.<br>Periudha e pandemisë ishte një sfidë për mësimdhënien por që rezulton e realizuar me sukses. Personeli IT i institucionit realizoi trajnime dhe pregatiti dokumenta trajnues për aftësimin e personelit akademik në mësimdhënien online.<br>*(Takimet dhe vizitat në institucion, Evidencat III.5-Udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie, III.1.2/III.1.3/III.1.4/III.1.5-Përdorimi i platformave Teams, Ofice, Edumeet, III.1.9-Format e zhvillimit të provimeve 2020 – 2021)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve. Në funksion të proçesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët e anatomisë, biokimik-klinik, infermierisë (i paisur me mulazhe), si dhe laboratori i informatikës. Laboratorët janë të paisur me mulazhe dhe mjete për manipulim që i krijojnë mundësi studentit për punë të pavarur dhe aftësim praktik.<br>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, stimulon dhe asiston në përfshirjen e pedagogëve në aplikime për projekte shkencore dhe projekte doktorature. ***Megjithatë, institucioni nuk mundëson mbështetje financiare për aktivitetin kërkimor-shkencor të pedagogëve.***<br>*(Evidencat III.3-Inventari i mjeteve laboratorike të DIF, I.24-Lista e projekteve të UGJ, I.25-Lista e mobiliteteve të UGJ, tabelat 16/19/20 të RVB, vizita dhe takimet në institucion)* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe | Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.<br>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatoi se:<br>• ***Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional. P.sh. një pedagog jo mjek (shëndet publik) zhvillon lëndët e Patologjisë së përgjithshme, Shtatzaninë dhe lindjen normale, Fizioterapinë, dhe Radiologjinë. Lëndët Infermieristikë në shtatzani dhe lindje normale dhe Infermieristikë e komplikacioneve të shtatzanisë kanë lektor me Bachelor në Infermieri të përgjithshme dhe Master Shkencor në Menaxhim infermieror.*** |

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

- ***Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë të profileve të ndryshme.***
- ***Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, kur legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën "Doktor Shkence".***

***GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.***

Sipas tabelës 2 të RVB personeli akademik i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit për tre vite akademike paraqitet si më poshtë:

| Tituj/ grada | 2022-2023 | | 2021-2022 | | 2020-2021 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Prof.Asc. | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Dr./PhD. | 4 | 7 | 3 | 1 | 2 | 2 |
| Msc. | 5 | 1 | 6 | 5 | 6 | 9 |
| Specializim | 0 | | 1 | 2 | 1 | 1 |
| **Totali** | **11** | **8** | **11** | **8** | **10** | **12** |
| *** Doktoraturë në proçes** | | | | | | |

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se ka një përmirësim të strukturës së titujve dhe gradave për PAE në këto 3 vite. Lidhur me treguesit e moshës. Lektorët me gradën Doktor i përkasin grupmoshës 36 – 65 vjeç. Në tabelat e ngarkesës mësimore të programit rezulton se mbi 80% e ngarkesës përballohet nga PAE.

Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e proçesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj. Personeli akademik është aftësuar dhe ka realizuar me sukses dhe metodat e punës on line sipas tematikave dhe profilit.

Në takimin me studentët konstatuam se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, me komunikimin dhe ndërveprimin e pedagogëve në orët e mësimit si dhe me materialet didaktike që pedagogët pregatisin për proçesin mësimor. Studentët kanë kërkesë shtimin e orëve të praktikës pasi nuk e ndjejnë veten të sigurtë në manipulim. Studentët ndihen të mbështetur dhe konstatohet një frymë pozitive hierarkie dhe bashkëpunimi.

*(Evidencat , III.3-Inventari i mjeteve laboratorike të DIF, II.9.1-Plani mësimor, II.28-Syllabuset e lëndëve, III.4-CV e personemit akademik, tabelat e RVB, takimet dhe vizita në institucion)*

**Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të

Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, proçesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proçes edhe studentët nëpërmjet

| | |
|---|---|
| studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | plotësimit të pyetësori të vlerësimit. Rezultatet e raportuara nga NJSBC në raportin vjetor tregojnë se studentët e gjykojnë tërheqës proçesin mësimor dhe sfidues detyrat e pedagogëve. Rezultatet e pyetsorëve përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit. Në takimin me studentët ata u shprehën se shpjegimi është i qartë dhe reflekton përdorimin e metodave inovative. Në orën e mësimit ka bashkëveprim interaktiv pedagog-student. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjelltë pedagog-student që reflektohet dhe në realizimin e konferencave studentore.<br><br>*(Evidenca III.6-Pyetësor studentor, takimet dhe vizita në institucion)* |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Institucioni ka riorganizuar NJSBC e cila koordinon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Institucioni përmes strukturave organizative të tij mbështet trajnimin dhe pjesmarrjen e stafit akademik në projekte zhvillimi në të cilat veç aftësimit shkencor fitohet dhe eksperiencë në mësimdhënie. Për promovimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve institucioni pregatit dhe boton në mënyrë periodike revistën "Kërkime Universitare", organizon aktivitete e konferenca me bashkëpunimin e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë.<br>Personeli është trajnuar dhe mbështetet vazhdimisht për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies on line.<br>Institucioni vlerëson arritjet e stafit akademik dhe i prezanton në analizat e departamentit dhe fakultetit.<br>Në takimet me stafin akademik u konstatua fryma positive e institucionit në raport me bashkëveprimin hierarkik dhe horizontal në nivel njësie qëndrore dhe njësie bazë.<br>*(Evidencat I.13-Raportet e veprimtarisë mësimore DIF, I.12-Raportet e veprimtarisë mësimore-kërkimore FSHN, VI.6-Raporte të NJSBC, III.5-Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie, III.14-Periodikët e botuar në UGJ)* |
| **Konkluzione** | *Institucioni garanton proçesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.* ***Megjithatë GVJ konstatoi se ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional, një pedagog jep më shumë se tre lëndë. Ka Lektorë pedagoge të kategorisë Msc, ku legjislacioni përcakton që lektorët duhet të jenë të zotërojnë gradën "Doktorë Shkence".***<br>*Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *profesional teorik të studentëve. Institucioni mbështet dhe promovon aktivitetin shkencor të stafit akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive.<br>UGJ prej disa vitesh përdor dhe sistemin e automatizuar për korrigjimin e provimeve CLEANSCORE të financuar nga AADF. ***Nuk ka evidenca të përdorimit të këtij sistemi në programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami".***<br>*(Evidencat I.2- Rregullore UGJ, I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.5-rregullore e FSHN, I.7-Rregullore e departamentit, I.9-Rregullore e programit të studimit, II.28-Syllabuset, III.8-Marrëveshje bashkëpunimi me AADF)* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloret e funksionimit të Fakultetit, dhe programit të studimit. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme. 20% e notës merret nga ndjekja e lëndës, plotësimi i detyrimeve dhe testimet gjatë vitit ndërsa 80% nga provimi final. Të dhënat për mënyrën e vlerësimit janë pasqyruar në tabelën 15 të RVB.<br>Në kreun V të rregullores së studimeve në UGJ përcaktohen qartë:<br>• Kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit<br>• Format e kontrollit të dijeve<br>• Sistemi i vlerësimit<br>• Sezonet e provimeve<br>• Kushtet për të hyrë në provim<br>• Mënyra e zhvillimit të provimeve<br>• Dokumentimi i rezultateve<br>• Proçedurat e ankimimit, riprovimeve, përmirësimit |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.9-Rregullore e programit të studimit, takimi me studentët)* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, provimi diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demostrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Proçedura e provimeve kryhet në bazë të Rregullores së dtufimrvr në UGJ, Rregullores së programit të studimit dhe rregulloreve të FSHN dhe DIF.<br>Në takimin me stafin akademik u informuam se provimet në këtë program studimi zhvillohen me shkrim. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit dhe firmoset nga drejtuesi i njësisë bazë para zhvillimit të provimit. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit dhe publikohen në platformën on lind ESSE3. Nota kaluese është 45 – 100 pikë.<br>*(Evidenca I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.9-Rregullore e programit të studimit, takimi me stafin, RVB)* |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i Departamentit të Infermierisë ku zhvillohet ky program studimi. Për këtë qëllim çdo vit departamenti mbledh kërkesat lidhur me metodat e mësimdhënies, i diskuton në department dhe përcakton buxhetin e nevojshëm i cili i paraqitet strukturave drejtuese të FSHN. Rezultatet e pyetsorit të studentëve veçanërisht vlerësimet e tyre për proçesin e mësimdhënies, stafin akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik analizohen nga NJSBC dhe diskutohen në departament.<br>*(Evidencat III.6-Pyetësor studentor, III.7-Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor, takimi me stafin akademik dhe studentët)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e | Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve. FSHN dhe Departamenti i Infermierisë çdo vit parashikojnë një buxhet të veçantë për shtimin apo përmirësimin e metodavë të mësimdhënies dhe modernizimin e bazës laboratorike. Institucioni inkurajon projektet e mobilitetit të stafit dhe pjesmarrjen e pedagogëve në trajnime për të përsosur metodat e mësimdhënies.<br>Studentët inkurajohen për punë të pavarur në ambientet e laboratorëve dhe në institucionet e kryerjes së praktikës për të krijuar sensin e autonomisë dhe forcuar besimin në aftësitë dhe gjykimin profesional. Gjatë proçesit mësimor dhe praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në zgjedhjen e temës ashtu dhe në hartimin e saj. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjelltë pedagog-student. |

| | |
|---|---|
| marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | *(Evidenca I.9-Rregullorja e programit të studimit, takimet me stafin akademik dhe studentët)* |
| **Konkluzione** | *Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Informacioni i detajuar gjendet në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. që realizohet me anë të provime, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare, praktika, provimi diplomimit. Provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i Departamentit të Infermierisë ku zhvillohet ky program studimi. Departamenti përfshin dhe studentët në këtë proçes. Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në rregulloren e programit të studimit, në tabelat e RVB dhe syllabuse përcaktohet se:<br>• 10% e pikëve të notës fitohen nga ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive<br>• 5% e pikëve të notës fitohen nga plotësimi i detyrimeve (laborator, detyra kursi)<br>• 5% e pikëve të notës fitohen nga testimet e kryer gjatë vitit<br>• 80% e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar<br>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në bazë të rregullores së departamentit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndeve/moduleve nga titullari lëndës/pedagogu. Nota minimale kaluese është nota 5 për të cilën duhen akumuluar të paktën 45 pikë. Nota maksimale është nota 10 që merret kur studenti akumulon 95 – 100 pikë. |

| | |
|---|---|
| | *(Evidencat I.9-Rregullore e programit të studimit, II.28-Syllabuset e lëndëve)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Në UGJ zbatohet prej disa vitesh sistemi i automatizuar i korigjimit te provimeve në disa programe studimi, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF. Në programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" nuk është përdorur ky sistem elektronik i vlerësimit. Metoda e përdorur është testimi me shkrim me sekretim të të dhënavë të studentit nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore, me qëllim ruajtjen e anonimatit të studentit. Pasqyrimi i vlerësimit të studentit kryhet nëpërmjet sistemit ESSE3<br>Gjatë periudhës së pandemisë Covid19, personeli akademik u trajnua për të përdorur gjerësish platformat elektronike për mësimdhënie dhe vlerësim të studentëve. Platforma më e përdorur ishte Microsoft Teams. *(Evidencat I.7-Rregullore e departamentit, I.9-Rregullore e programit të studimit, II.28-Syllabuset, III.8-Marrëveshje bashkëpunimi me AADF)* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollohet nga titullari lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.<br>Në përfundim të proçesit mësimor pedagogu i lëndës i komunikon studentit fitimin ose jo të mundësisë për të hyrë në provim (bazuar në informacionin e sekretarisë mësimore për frekuentimin dhe pagesat) dhe rezultatin e vlerësimit të vazhduar.<br>Proçesverbali i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagaogët që kanë realizuar provimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit. GVJ u njoh në sekretarinë mësimore me formatin e fletës së provimit dhe proçedurën. *(Evidencat I.7-Rregullore e departamentit, I.9-Rregullore e programit të studimit, takimi me sekretarinë mësimore)* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e proçesit mësimor për çdo lënde dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Studenti ka të drejtë të shohë rezultatet e provimit të cilat komentohen nga peagogu. Studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin e provimit.<br>*(Evidencat I.7-Rregullorja e departamentit të infermieristikës, I/9-Rregullorja e programit të studimit)* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | UGJ ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Në rregulloren e studimeve në kodin e etikës dhe në fund të çdo syllabusi pasqyrohen penalitete për rastet e kopjimit apo plagjiaturës. Përgjegjësi i departamentit ose një person i |

| | |
|---|---|
| | deleguar prej tij është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Nëse konstatohet kopjim në provim apo detyra kursi studenti merr penalitete sipas rregullores së UGJ.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, II.28-Syllabuset, III.10-Kodi i Etikës)* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Departamenti i Infermierisë i garanton studentëve vlerësimin bazuar në meritë. Institucioni është kujdesur të përcaktojë në rregullore mënyrën e vlerësimit të dijeve. Në syllabuse dhe në rregulloren e programit të studimit shënohet se vlerësimi është i vazhduar, 20% e pikëve të vleresimit merren nga aktivizimi, projektet, provimet e pjesshme të kryera gjatë proçesit mësimor dhe 80% e pikëve fitohen në provimin përfundimtar të lëndës. Rregullorja përcakton se provimet mund të bëhen me shkrim ose me gojë. Në programin e studimit Bachelor "Infermier-Mami" është praktikuar provimi me shkrim me pyetje shtjelluese dhe/ose ushtrime me alternativa.<br>Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer. Studentët shprehen të kënaqur me proçedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, I.5-Rregullore e FSHN, I.7-Rregullore e Departamentit të Infermierisë, II.28-Syllabuset, III.10-Kodi i Etikës, Takimi me studentët)* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.<br>**Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin para se vlerësimi të marrë formë përfundimtare. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit.<br>Nëse studenti nuk është dakord me rezultatin e provimit dhe sqarimin nga pedagogu, i paraqet ankesë me shkrim dekanit i cili bën verifikimet e duhura dhe në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit, nëse konstaton parregullsi, mund të vendosë për ndryshimin e komisionit dhe ripërsëritjen e provimit. E gjithë proçedura e ankesës dhe rivlerësimi të studentit dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, I.9-Rregullore e programit të studimit)* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe proçesin e ankimimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndeve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi Dekanit, Përgjegjësit të departamentit dhe komisionit të provimit. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. UGJ ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Infermieri-Mami. Studentët liçensohen në fushën e Mamisë por janë të aftë të ofrojnë dhe shërbim infermieror. Kjo pregatitje e dyfishtë është shumë e rëndësishme sidomos në zona ku ka mungesë të personelit infermieror. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. Shpërndarja e ECTSve sipas tipit të veprimtarisë është në përputhje me aktet ligjore në fuqi (standardi II.1 kriteri 3). Programi harmonizon njohuritë e fituar nga lëndët bazë (shkenca sociale dhe të shëndetit, shkenca biomedikale, anatomi, fiziologji, anatomi patologjike&farmakologji, fizpatologji riprodhuese) me njohurinë e fituara nga lëndët karakterizuese që kanë fokus pregatitjen specifike në profesionin "Infermier-Mami" (bazat e infermieristikës, shkenca infermierore, risqet dhe komplikacionet e shtatzanisë, infermieristikë e komplikacioneve obstetrikale, gjinekologji dhe shëndet riprodhues, infermieristikë në gjinekologji dhe shëndet riprodhues, puerikulturë dhe neonatologji, shtatzani dhe lindje normale, infermieristikë në shtatzani dhe lindje normale, lëndë kirurgjikale dhe urgjencë mjekësore, pediatri) me lëndët ndërdisiplinore (patologji e përgjithshme, biokimi mjekësore dhe biofizikë, lëndë me zgjedhje) dhe |

| | |
|---|---|
| | ato plotësuese (gjuhë e huaj, informatikë dhe statistikë, praktikë infermierore). Orët e praktikës mësimore dhe profesionale u japin mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të praktikohenn gjatë manipulimeve në manekinë apo paisje mjekësore që janë në dispozicion në studentevë në laboratorët e FSHN.<br>Lëndët me zgjedhje (psikologji, shëndet mjedisor, dietologji, fazë preanalitike, menaxhim projektesh, radiologji, fizioterapi) synojnë të zhvillojnë prirje të veçanta të studentëve dhe krijojnë një premisë të mirë për kualifikimin në nënspecialitete, punësim në sektorë menaxhues etj.<br>*(Evidencat II.9.1-Plani mësimor i programit të studimit, II.28-Syllabuset)* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës dhe mamisë përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë-statistikë, psikologji, menaxhim projektesh etj. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. FSHN ka një laborator të kompletuar të informatikës në funksion të pregatitjes së studentëve.<br>*(Evidencat II.9.1-Plani mësimor i programit të studimit, II.28-Syllabuset, vizita e ambienteve në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Syllabuset e lëndëve përcaktojnë kompetencat dhe aftësitë që duhet të ketë studenti në përfundim të ciklit mësimor të lëndës përkatëse.<br>Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të tyre. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët.<br>*(Evidencat II.28-Syllabuset, III.1.11-Orari i konsultimeve, Takimi me studentët dhe stafin akademik)* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e | Në programi Bachelor "Infermier-Mami" janë angazhuar kryesisht pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie.<br>Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit-mami dhe për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu gjatë programit të studimit studentët fitojnë njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit. Studentët marrin njohuri të plota në Mami dhe njohuri të shërbimit infermieror të përgjithshëm.<br>Programi i studimit është specifik dhe bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimi në auditor. Gjatë realizimit të proçesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve, diskutimet e |

| | |
|---|---|
| ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | rasteve klinike në seminare, praktika mësimore dhe veçanërisht ato profesionale.<br>Institucioni inkurajon studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët janë përfshirë në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme.<br>*(Takimi me studentët dhe stafin akademik)* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarin e promocionit shëndetësor, departamenti i infermierisë në bashkëpunim me departamentet e tjera të FSHN si dhe mjekë nga institucione shëndetësorë apo institucione arsimore vëndase dhe të huaj organizojnë seminare, konferenca apo leksione të hapura, tavolina të rrumbullakta jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjesmarrës në këto aktivitete janë dhe studentët. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve. Në takimin me studentët u njohëm me angazhimin e studentëve të programit Bachelor "Infermieri-Mami" në aktivitetet e organizuara në kuadër të tetorit rozë (për parandalimin e kancerit të gjirit), për promocionin shëndetësor për HIV, apo pjesmarrjen e tyre në trajnime te qendra terapeutike e fëmijëve me aftësi ndryshe. Personeli akademik i Departamentit të Infermierisë është i përfshirë në aktivitete shkencore, publikime në funksion të rritjes së kualifikimit akademik gjithashtu organizon dhe merr pjesë në leksionet e hapura në kuadër të aktiviteteve promocionale.<br>*(Evidencat III.15 (1.2.3) Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore në UGJ, Takimet në institucion me studentë dhe pedagogë)* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Infermieri-Mami. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë, terminologji mjekësore, ekonomi menaxhimi, etikë. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion të një pregatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *apo konferenca shkencore me pjesmarrjen e mjekëve të shquar vendas apo të huaj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Studentit në fund të studimeve i lind e drejta të pajiset me diplomë Bachelor "Infermier-Mami" pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur diplomë ose provimin final. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e studimeve të UGJ. Në këtë rregullore, kreu VIII i dedikohet Diplomimit. Në këtë kapitull të rregullores përcaktohen kushtet e diplomimit për të gjitha programet mësimore (detyrimet që duhet të përmbushë studenti), pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome (pragu është nota 8 ose një kufi më i lartë i vendosur nga njësia bazë), rregullat për pregatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës, rregullat për pregatitjen dhe realizimin e provimit të formimit. Ky informacion bëhet publik për studentët. Rregullat globale të përcaktuara në këtë rregullore pasqyrohen dhe në rregulloret e tjera institucionale (të FSHN dhe Departamentit të Infermierisë) dhe në rregulloren e programit të studimit.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, I.5-Rregullore e FSHN, I.7-Rregullore e Departamentit të Infermierisë, I.9-Rregullore e programit të studimit)* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Fokusi i programit Bachelor "Infermier-Mami" është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në provimin përfundimtar ose në përgatitjen e një teme diplome. Në fillim të vitit të fundit të studimeve, pedagogët e Departamentit të Infermierisë i orientojnë studentët dhe iu japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzojnë në hartimin e temës së diplomës, skicimin e strukturës së studimit mbledhjen e informacionit apo realizimin e tij në laboratorët e departamentit apo institucionet shëndetësore me të cilat bashkëpunon institucioni si dhe prezantimin e materialit. Studenti ka në dispozicion dhe Manualin e Punimit të Diplomës, dokument shtesë i Rregullores së studimeve në UGJ.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, III.11.2-Manuali i punimit të diplomës)* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3**. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e studimit.<br>Komisioni i ngritur me propozim të departamentit dhe i aprovuar nga Dekani përgatit tezën përfundimtare e cila firmoset dhe aprovohet nga Përgjegjësi i departamentit dhe Dekani. Provimi përfundimtar i formimit mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar përcaktohet në rregulloren e programit të studimit.<br>Rezultatet e provimit të përgjithshëm përfundimtar u jepen studentëve në fund të ditës së provimit. Korrigjimi i provimit përfundimtar kryhet nga një komisioni. Vlerësimi përfundimtar i provimit të formimit pasqyrohen në proçesverbalin përkatës. Proçesverbali përfundimtar i rezultatit të provimeve firmoset nga komisioni i vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, III.11-Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar, takimet me stafin në institucion)* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.<br>Përpara përfundimit të studimeve departamenti përcakton fushat e studimit për punimin e diplomës.<br>Temat e diplomës dhe pedagogët udhëheqës të cilat pasi miratohen në departament ju vihen në dispozicion studentëve. Studentët asistohen nga pedagogët udhëheqës së temës së diplomës gjatë hartimit dhe realizmit të studimit. Pedagogu udhëheqës pregatit progamin e punës dhe në bashkëpunim me studentin përcakton afatet e përafërta të realizimit, konsulton studentin gjatë gjithë proçesit të realizimit të punimit, vlerëson rezultatet dhe firmos dhe miraton punimin duke lejuar mbrojtjen përpara komisionit.<br>Guida për realizimin e punimit të diplomës është Manuali i Punimit të Diplomës.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, III.11.1-Miratimi i fushave të studimit, III.11.2-Manuali i Punimit të Diplomës)* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Departamenti i Infermierisë i siguron studentëve infrastrukturën e nevojshme logjistike për realizimin e studimit. Studentët mbledhin të dhënat në strukturat shëndetësorë ku realizohet studimi ose realizojnë pjesën ekserimentale në laboratorët e departamentit nën mbikqyrjen dhe mbështetjen e pedagogut udhëheqës.<br>*(Evidencat III.2/III.3-Inventaret e mjeteve teknologjike-didaktike dhe laboratorike të Departamentit të Infermierisë, vizita e ambienteve në institucion)* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes | Vlerësimi përfundimtar i provimit të diplomës apo temës bëhët me notë. Teza korrigjohet nga komisioni vlerësimit. Proçes verbali përfundimtar firmoset nga të gjithë anëtarët e komsionit dhe dorëzohet në sekretari. |

| | |
|---|---|
| së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisionit të ngritur nga Dekani i fakultetit, që vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës.<br>Në takimet me stafin dhe GVB në institucion u informuam se në periudhën 3 vjeçare 2020 – 2023 institucioni ka aplikuar diplomimin me provim të përgjithshëm si mënyrë më efikase në periudhën e pandemisë.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, III.11.2-Manuali i punimit të diplomës, takimet me stafin)* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Suplementi i diplomës është organizuar në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 të MASR "Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së suplementit të diplomës".<br>Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti, me kërkesë të tij, pajisjet dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e parë të studimeve bachelor në Infermier-Mami. Proçedura që ndiqet për tërheqjen e programit të studimit përcaktohet në rregulloren e departamentit.<br>*(Evidencat I.4-Rregullore e studimeve në UGJ, I.2-Rregullore e UGJ, II.5-Model diplome Bachelor Infermier-Mami", II.6.1-Model Suplementi i Diplomës)* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar. Institucioni mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretaritë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike dhe regjistri i tërheqjes së diplomës dhe çertifikatave. Administrimi i dokumentacionit të mësipërm bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e UGJ dhe Rregulloren e sekretarisë mësimore. GVJ inspektoi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit dhe plotësimin e regjistrave në sekretarinë mësimore dhe i gjeti ato konform ligjit dhe rregulloreve.<br>*(Evidencat I.1-Statuti i UGJ, III.13-Rregullore e sekretarisë mësimore, vizita në ambientet e sekretarisë mësimore)* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ndjek një proçedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Bachelor "Infermieri Mami dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Institucioni ka përgatitur edhe një manual në lidhje me punimin e diplomës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.* |

| | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Standardi IV.1**
**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.<br>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatoi se:<br><br>Sipas tabelës 2 të RVB personeli akademik i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit për tre vite akademike paraqitet si më poshtë: |

| Tituj/ grada | 2022-2023 | | 2021-2022 | | 2020-2021 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Prof.Asc. | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Dr./PhD. | 4 | 0 | 3 | 0 | 2 | 1 |
| ME | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Msc. | 4 | 5 | 5 | 4 | 5 | 9 |
| Specializim | 0 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 |
| **Totali** | **11** | **6** | **11** | **6** | **10** | **11** |
| *** Doktoraturë në proçes** | | | | | | |

- ***Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional. P.sh. një pedagog jo mjek (shëndet publik) zhvillon lëndët e Patologjisë së përgjithshme, Shtatzaninë dhe lindjen normale, Fizioterapinë, dhe Radiologjinë. Lëndët Infermieristikë në shtatzani dhe lindje normale dhe Infermieristikë e komplikacioneve të shtatzanisë kanë lektor me Bachelor në Infermieri të përgjithshme dhe Master Shkencor në Menaxhim infermieror.***

- ***Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë të profileve të ndryshme.***
- ***Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, kur legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën "Doktor Shkence".***

***GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.***
***Gjithashtu GVJ konsideron se duhet të shtohet numri i pedagogëve të profilit infermier dhe sidomos mami. Nga takimi me stafin u cilësua se është vështirë të gjendet staf me kriteret e duhura, por GVJ vëren se në stafin me kohë të pjesshme ka personel akademik me MCc. Prandaj, GVJ konsideron që të merren në punë staf akademik në profilin infermier dhe mami.***

*(Evidenca III.4 CV e personelit akademik; Anekse Infermier – Mami; Evidenca I.16 Organograma e Departamentit te Infermierise; Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore, Njësisë Bazë dhe stafin)*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga dokumentacioni i sjellë nga UGJ, GVJ konstaon se programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kritereve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 datë 24.01.2018. Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimit teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (praktikë profesionale). *Referuar llogaritjeve në planin mësimor, orët totale janë 4500*

| **Bsc "Infermieri Mami"** | **Viti I** | **Viti II** | **Viti III** | **Në total** |
|---|---|---|---|---|
| **Në auditor** | | | | **1976 (44%)** |
| - Leksione | 435.5 | 365 | 355 | 1155.5 |
| - Seminare | 183.5 | 85 | 52 | 320.5 |
| - Praktika profesionale | - | 250 | 250 | 500 |
| **Punë e pavarur e studentit** | | | | **2524 (56%)** |
| **Gjithsej** | | | | **4500** |

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se ka një përmirësim të strukturës së titujve dhe gradave për PAE në këto 3 vite. Në tabelat e ngarkesës mësimore të programit rezulton se mbi 80% e ngarkesës përballohet nga PAE.

*(Evidenca III.4 CV e personelit akademik; Anekse Infermier – Mami; Evidenca III.11 Program i provimit te pergjithshem perfundimtar Bachelor Infermier – Mami)*

**Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | numëri i stafit të përfshirë në këtë program studimi është pothuajse stabel.<br>Departamenti i Infermierisë që ofron programin e studimit angazhon në mësimdhënie personel akademik me kualifikim kryesisht të fushës së mjekësisë dhe infermierisë të shpërndarë në vite sic është shpjeguar edhe më sipër.<br><br>***Pavarësisht se numëri i stafit raportohet i qëndrueshëm, GVJ vëren se stafi në pjesën më të madhe nuk është me profil Infermieror dhe Mami. Kjo është një pikë e dobët në të cilën UGJ duhet të punoj më shumë.*** Nga vizita e GVJ në Zyrën e personelit, u konstatua se dokumentacioni ishte i rregullt.<br><br>*(Evidenca III.4 CV e personelit akademik; Anekse Infermier – Mami; Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë; Takimi me zyrën e personelit)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Institucioni ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në rregulloren e Punësimit të personelit akademik dhe administrativ (neni 3,5,8 & 9), Rregulloren e UGJ (neni 27), Statutin e UGJ (56), ku përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv, nga njësia bazë drejt njësisë kryesore, andej drejt Rektorit. Kërkesat për punësim miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, pastaj lajmërimi bëhet publik. Rektori miraton komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e personelit akademik. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik dhe publikohet në Buletin e Prokurimeve Publike.<br>Për personelin me kohë të pjeshme UGJ bazuar në Statutin e UGJ (neni 33, gërma f), komisioni ad-hoc miratohet nga Dekani.<br><br>*(Evidenca 1 Statuti i UGJ; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca 14 Rregullore për Punësimin dhe Përzgjedhjen e Stafit Akademik dhe atij Adiministrativ Ne UGJ; Evidenca IV.4 Propozim per personel akademik me kohe te plote; Evidenca IV.4.1 Propozim per personel akademik me kohe te pjesshme dhe kohezgjatje te caktuar; Evidenca IV.4.2 Buletini njoftimeve publike; Evidenca IV.6 Procedurë e punësimit të personelit akademik në DMIF; Tabela Aneks RVB BSc. Infermieri; Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore; Takim me përfaqsues të Burimeve Njëerëzore.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për | Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentua angazhimi i personelit ndihmës akademik, ata asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirembajtjen e laboratoreve.<br>Në tre vite akademike në rang departamenti, personeli ndihmës akademik është si më poshtë vijon:<br>2020 – 2021 2 personel ndihmës akademik; |

| | |
|---|---|
| mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | 2021– 2022 2 personel ndihmës akademik;<br>2022 – 2023 2 personel ndihmës akademik;<br>***Personeli ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike janë dy dhe kanë kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij.***<br><br>*(Evidenca I.15 Organograma e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.16 Organograma e Departamentit te Infermierise; Evidenca IV.7 Detyrat dhe ngarkesa e personelit ndihmës akademik; Evidenca III.4 CV e personelit akademik; Tabela Aneks RVB BSc. Infermieri.)* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Zyra e Burrimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në tabelat përmbledhëse, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative. ***Nga takimi me përfaqësuesit e Zyra e Burrimeve Njerëzore dhe nga vëzhgimi i CV të personelit akademik, GVJ konstaton se CV e personelit nuk janë përditësuar. GVJ konsideron që UGJ duhet të punojë më shumë në këtë drejtim.***<br><br>*(Evidenca III.4 CV e personelit akademik; Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Bazë; Takim me përfaqsues të Burimeve Njëerëzore.)* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi dhe ju vunë në dispozicion marrëveshje të bashkëpunit me institucione të tjera. UGJ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshje janë nënshkruar me Spitalin Rajonal "Omer Dishani" Gjirokastër. ***Në listën e marrëveshjeve mungon Sistemi i Shërbimit Parësor (qendrat shëndetësore).*** Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë, ata raportuan se nuk kanë ende një marrveshje të tillë, por në rast se studentët dëshirojnë të kryejnë praktikën pranë këtyre qendrave, ata e kanë të mundur, në bazë të marrveshjeve individuale. ***Bazuar në Misionin e programit të studimit, ky program synon të përgatisë specialistë që të punojnë në spitale dhe konsultorë. Prandaj GVJ e shikon të rëndësishme marrëveshjen me Shërbimin parësor dhe rekomandon që një pjesë e praktikave të zhvillohen pikërisht aty.*** |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">(Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca II.17 Misioni i programit Bachelor Infermier – Mami; Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Bazë)</td></tr>
<tr><td>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</td><td colspan="4">Nga takimi me Drejtuesit e Njësisë kryesore dhe Njësisë Bazë, në fiilim të ciklit të praktikës referentë e shërbimeve spitalore pasi janë njoftuar parapraksisht dhe zyrtarisht për kalendarin e praktikës klinike, pajisen me listën e studentëve dhe objektivat specifike specifike për çdo shërbim. Në përfundim të praktikës kthehet në institucion lista me kontrollin e frekuentimit dhe një relacion në që përmban frekuentimin, paraqitjen, angazhimin dhe seriozitetin e studenteve në praktikat klinike profesionale.<br>Çdo vit të ri shkollor ndahen grupet e praktikave, printohen fletët me emrat e studenteve, datat e realizimit të praktikës, vendi i realizimit, mentori dhe vendi për relacion. Këto mblidhen në fund dhe shërbejnë për vlerësim të studentit.<br><br>(Takimi me udhëheqësit e praktikave; Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Bazë; RVB-BSc. Infermieri.)</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në UGJ në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Gjithashtu GVJ konsideron se duhet të shtohet numri i pedagogëve të profilit infermier dhe sidomos mami. Nga takimi me stafin u cilësua se është vështirë të gjendet staf me kriteret e duhura, por GVJ vëren se në stafin me kohë të pjesshme ka personel akademik me MCc. Prandaj, GVJ konsideron që të merren në punë staf akademik në profilin infermier dhe mami. Pavarësisht se numëri i stafit raportohet i qëndrueshëm, GVJ vëren se stafi në pjesën më të madhe nuk është me profil Infermieror dhe Mami. Kjo është një pikë e dobët në të cilën UGJ duhet të punoj më shumë.<br>Institucioni ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në aktet rregullatore të saja.Nga takimi me përfaqësuesit e Zyra e Burrimeve Njerëzore dhe nga vëzhgimi i CV të personelit akademik, GVJ konstaton se CV e personelit nuk janë përditësuar. GVJ konsideron që UGJ duhet të punojë më shumë në këtë drejtim.<br>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi dhe ju vunë në dispozicion marrëveshje të bashkëpunit me institucione të tjera. GVJ e shikon të rëndësishme marrëveshjen me Shërbimin parësor dhe rekomandon që një pjesë e praktikave të zhvillohen pikërisht aty.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

| **Standardi IV.2** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se UGJ ka hapsirat e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj. Hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboratoreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e e leksioneve në Power Point.<br><br>*(Vizita në institucion; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ (tab A);)* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Sallat e leksionit janë të pajisura me projektorë që mundësojnë demostrimin me video të leksioneve të ndryshme. Personeli akademik ka kompjuter personal me lidhje internet, që bën të mundur edhe zbatimin e metodave të mësimdhënies në distancë.<br><br>*(Vizita në institucion; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ (tab C);)* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Salla për praktikë lëndore/profesionale dhe laboratorë për lendën përbëjnë një bazë të konsiderueshme në funksion të programit të studimit dhe projekteve kërkimore të studentëve.<br>Në shërbim të mësimdhënies dhe zhvillimit të praktikave laboratorike UGJ kishte në dispozicion për studentët:<br>- 1 laborator anatomie – që shërben për lëndët anatomi dhe fiziologji;<br>- 1 laborator infermierie – që shërben për realizimin e manipulimeve venoze, muskulare, subcutane. Vendosja e katetereve urinare, sondave nazogastrike. Mulazhe të ndryshme të organeve riprodhuese. Manekine për procesin e lindjes, etj;<br>- 3 laboratore informatike<br>*(Vizita në institucion; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ (tab C))* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Institucioni ka të instaluar tre salla informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit, ku zhvillohet lënda e Informatikës dhe Statistikës gjatë së cilës studentët marrin njohuri efektive mbi përdorimin e programeve bazë kompjuterike.<br><br>*(Vizita në institucion; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ (tab C))* |

| Konkluzione | *GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapsirat e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj.*<br>*Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik.*<br>*Institucioni ka të instaluar tre salla informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit, ku zhvillohet lënda e Informatikës dhe Statistikës.* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, në bibliotekë, takimin me stafin dhe studentët u informua se, studentët dhe stafi kanë në dispozicion tekste fizike dhe on-line. Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. ***Megjithatë literatura e përdorur (në bazë të syllabuseve) është shumë e vjetër, gjë që është një pikë e dobët për këtë program studimi. Përditësimin i fundit i bibliotekës është realizuar me libra të vitin 2021, por nuk kishte libra të fushës mjekësore. GVJ e konsideron si një pikë të dobët mbi të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë.***<br><br>*(Vizita në institucion; Vizita ne bibliotekë; Takimi me stafin dhe student; Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT; Evidenca IV.14 Biblioteka,Kartelë personale e përdoruesit; Evidenca IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit)* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ u informua se stafi akademik çdo fund viti akademik përditëson syllabusin, temat përkatëse, literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, ciklin e leksioneve dhe bazuar në këtë përditësim bën dhe kërkesën për literaturë fizike apo on-line. ***GVJ konstaton se syllabuset kanë literaturë të pa përditësuar dhe se në vite kjo literaturë nuk ka ndryshime gjatë viteve të fundit, gjithashtu përditësimi i bibliotekës ka literaturë të vjetëruar. Kjo është një pikë e dobët dhe GVJ rekomandon që të punohet më shumë në këtë drejtim.***<br><br>*(Evidenca II.28 Syllabus Mami 2022-2023; Evidenca II.28.1 Syllabus Mami 2021-2022; Evidenca II.28.2 Syllabus Mami 2020-2021;* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | GVJ konstatoi se UGJ vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën mësimore që ndodhet në godinën C të UGJ. Biblioteka është në dispozicion të stafit dhe studentëve në mënyrë të barabartë në të gjitha programet dhe ciklet e studimit. ***Biblioteka nuk ka një rregullore të brendshme por ka një manual përdorimi përsa i pëket mënyrës së tërheqjes, shfrytëzimit dhe trajtimit të librave*** dhe nuk ka asnjë kufizim të shfrytëzimit të librave në bibliotekë që lidhet me programin apo fushën e studimit. Studentët mund të shfrytëzojnë gjithë fondin e bibliotekës, pavarësisht nga fusha që studiojnë. ***GVJ konstaton se përditësimi i bibliotekës është bërë në vitin 2021, por nuk kishte libra të fushës mjekësore e rezulton me literaturë të vjetër dhe GVJ rekomandon që të bëhet pasurimi i bibliotekës.***<br><br>*(Vizita në bibliotekë Evidenca II.28 Syllabus Mami 2022-2023; Evidenca II.28.1 Syllabus Mami 2021-2022; Evidenca II.28.2 Syllabus Mami 2020-2021; Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT; Evidenca IV.14 Biblioteka,Kartelë personale e përdoruesit; Evidenca IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit)* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin e bibliotekës u informua se ka një numër të konsiderushëm të literaturës. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë pa pagesë shfrytëzimin jo vetëm të literaturës fizike, por edhe on-line, për realizimin sa më të mirë të procesit mësimor dhe moduleve të programive të studimeve.<br>*(Vizita në bibliotekë; Evidenca II.28 Syllabus Mami 2022-2023; Evidenca II.28.1 Syllabus Mami 2021-2022; Evidenca II.28.2 Syllabus Mami 2020-2021; Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT; Evidenca IV.14 Biblioteka,Kartelë personale e përdoruesit; Evidenca IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ konstatoi se UGJ disponon librari online si U-Library, J STOR, programi COBISS, etj. Gjithashtu abonime në revista të ndryshme. Kjo gjë i jep mundësi studentëve dhe stafit akademik të shfrytëzojë pa pagesë literaturat në funksion të programit të studimit.<br><br>*(Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT; Vizita në bibliotekë)* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të | GVJ konstatoi se fondi i bibliotekës mbulonte fushat të ndryshme të shkencave dhe gjithashtu të shkencave mjekësore dhe shkencave teknike mjekësore, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Bibliotekë ofronte |

| | |
|---|---|
| tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | mundësi kërkimi të informacionit në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës. Kjo bibliotekë ofronte 53 proste dhe 5 kompiutera.<br><br>*(Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT; Vizita në bibliotekë)* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Në bibliotekën e UGJ kishte një sallë studimi me 53 karrige dhe 5 pajisje kompjuterike që krijonte mundësinë për të punuar në mënyrë individuale apo edhe në grup. Oraret e shfrytëzimit të bibliotekës ishin përshtatur për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimit dhe kishte tre punonjëse. Kjo gjë u krijonte mundësinë studentëve për shfrytëzimin maksimal të saj.<br><br>*(Vizita në bibliotekë; Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT)* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Orientimi i studentëve për përzgjedhjen e literaturës në përgjithësi bëhej nga stafi akademik.<br>***GVJ konstatoi se nuk kishte një literaturë bashkëkohore ku stafi kishte mundësi të përditësonte leksionet. Pasurimi i bibliotekës ishte bërë në vitin 2021 për herë të fundit, por që nuk ishin marrë libra të fushës mjekësore. Gjithashtu literatura ishte e vjetëruar.***<br>Procedurat për përdorimin e bibliotekës janë të parashjikuara në rregulloren e Bibliotekës dhe tek Manuali i përdorimit. Gjithashtu studentët paisen dhe me një kartelë përsonale kur ata shfrytëzojnë bibliotekën.<br><br>*(Vizita në bibliotekë; Evidenca III.9 Informacion per biblioteken U-lIBRARY, fONDI I LIBRIT; Evidenca IV.14 Biblioteka,Kartelë personale e përdoruesi; Evidenca IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit; Evidenca IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës )* |
| **Konkluzione** | *Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit.* ***Megjithatë literatura e përdorur (në bazë të syllabuseve) është shumë e vjetër, gjë që është një pikë e dobët për këtë program studimi. Përditësimin i fundit i bibliotekës është realizuar në vitin 2021, por që nuk përmbante libra të fushës së mjekësisë. GVJ e konsideron si një pikë të dobët mbi të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë.*** *IAL disponon librari online si U-Library, J STOR, programi COBISS, etj. Gjithashtu abonime në revista të ndryshme. Kjo bibliotekë ofronte 53 proste dhe 5 kompiutera.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UGJ ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. UGJ disponontе softin PITAGORA, ku mbahet gjithë informacioni për studentin, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS.<br><br>*(Vizitë te sekretaria; Evidenca 10 Rregullore e Sekretarise mesimore; Evidenca V.3 Dosja personale e studentit nga hyrja deri ne diplomim; Sistemi PITAGORA)* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.<br>**Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Zyra e Burimeve Njerëzore në UGJ administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. GVJ nga takimi me përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerëzore konstatoi se dosjet e personelit akademik ishin të plotësuar.<br><br>UGJ përdorin sistemin Pitagora për menaxhimin e të dhënave mësimore dhe për personelin dhe studentët. Çdo pedagog apo student ka akses në sistemin Pitagora. Pedagogët aty marrin informacion dhe gjithashtu e përdorin për hedhjen e notave, evidencave, kontratave, orët suplement, ngarkesat mësimore. Studentët marrin informacion në lidhje me vlerësimin, realizojnë rregjitrimet për provime, shikojnë planet mësimore, programet e lëndëve, etj.<br><br>*(Evidenca 14 Rregullore për Punësimin dhe Përzgjedhjen e Stafit Akademik dhe atij Adiministrativ Ne UGJ; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA; Evidenca IV.6 Procedurë e punësimit të personelit akademik në DMIF; Takimi me Zyrën e burimeve njerëzore; Sistemi PITAGORA)* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit | UGJ disponontе infastrukturën për një edukim në distancë, por që këtë infrastrukturë e përdorte dhe për informimin e studentëve në lidhje me veprimtari, takime, mbjedhje, diskutime, kërkim shkencor, mobilitete, etj. Një shëmbull është dhe mësimi online gjatë pandemisë Covid 19, me anë të microsoft teams. Normalisht platforma Teams është një platformë që të jep mundësinë për dhënije dhe marrje informaciojni, |

| | |
|---|---|
| ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | por dhe për një interaktivitet mes mësimdhënësve dhe mësimmarrësve, gjë që e bën këtë platformë një mënyrë të suksesshme mësimdhënije.<br><br>*(Evidenca III 1.2 Implementimi i platformës së mësimit online Edumeet; Evidenca III 1.3 Implementimi i platformës së mësimit online Edumeet; Evidenca III 1.4 Manuali i perdorimit te platformes TEAMS per studentet; Evidenca III 1.5 Manuali i perdorimit te seormes teams)* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | UGJ me anë të sistemit Pitagora jep informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuentonte. Falë Zyrës së IT bëhej e mundur mirëmbajtja e sistemit duke bërë të mundur përdorimin në çdo kohë.<br><br>*(Sistemi PITAGORA)* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | UGJ zotëron një faqe ëeb aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe jep infomacioneve të ndryshme.<br><br>*(Faqja ËEB e UGJ.)* |
| **Konkluzione** | *UGJ ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. UGJ disponoņte softin PITAGORA, ku mbahet gjithë informacioni për studentin, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS.*<br>*UGJ zotëron një faqe ëeb aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe jep infomacioneve të ndryshme.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të | Në UGJ, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit.<br>UGJ gjeneron të ardhura nga studentët, shërbimet përkundrejtë palëve të treta, projekteve, etj. Shpërndarja financiare realizohej sipas nevojave që kanë njësitë përberëse të institucionit. Propozimet vinin |

| | |
|---|---|
| studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | nga baza dhe miratimi i tyre bëhej nga Rektorati dhe Bordi i Administrimit.<br><br>*(Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022)* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Proçesi i hartimit të planit financiar nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësitë bazë (departamentet) dhe strukturat administrative të fakultetit. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Në planin e financimit përfshiheshin zëra për: burimet njerëzore dhe infrastrukturore, materialet e konsumit, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimin e bibliotekës, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm si dhe mundësitë e mbështetjes finanaciare.<br><br>*(Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | GVJ bazuar në shkresat e sjella, konstastohet se UGJ harton pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e Universitetit dhe masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar në çdo fundvit akademik.<br><br>*(Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | GVJ konstatoi se Drejtoria e Shërbimeve dhe administrimit në UGJ, harton raportet vjetore për realizimin e buxhetit të miratuara nga Senati Akademik dhe Bordi i administrimit dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme për të garantuar ecurinë normale. Ky raport normalisht ndjek vijën vertikale nga lart poshtë duke bërë të mundur që departamentet të marrin informacionin e duhur në kohë reale.<br><br>*(Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022, Takimi me drejtuesin e njësisë kryesore dhe atë bazë; Takimi me pedagogë)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | GVJ bazuar në RVB, referencat përkatëse si dhe takimin me drejtuesit e institucionit konstaton se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.<br>Të ardhurat janë nga:<br>- Financim nga buxheti i shtetit<br>- Të ardhura dytësore nga: tarifa rregjistrimi, tarifa shkollimi dhe shërbime të tjera që ofron institucioni.<br><br>*(Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; Evidenca Anekse Infermier – Mami, Tab 18)* |
| **Konkluzione** | *Në UGJ, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. UGJ gjeneron të ardhura nga shteti dhe studentët, shërbimet përkundrejtë palëve të treta, projekteve, etj. Shpërndarja financiare realizohej sipas nevojave që kanë njësitë përbërëse të institucionit. Propozimet vinin nga baza dhe miratimi i tyre bëhej nga Rektorati.*<br>*Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve | GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore, grupin e RVB, konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë |

| | |
|---|---|
| nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.<br>Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë për transferim për largim apo kalim në UGJ ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.<br><br>*(Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.7 Regullore e Departamentit Infermieri e pergjithshme; Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca II.20 Procedure e transferimit te studenteve; Evidenca V.14 Lista e studenteve te larguar ose transferuar; Evidenca V.14 Lista e të transferuaeve dhe të larguarve nga UGJ)* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVJ vuri re se ky institucion bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, nr. 80/2015, statutin e UGJ siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për tu rregjistruar në Programin e Studimit Bachelor në "Infermieri Mami".<br>Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme.<br><br>*(Evidenca 1 Statuti i UGJ; Evidenca 10 Rregullore e Sekretarise mesimore; Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ; Evidenca I.26 Leksione të hapura)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | GVJ në takimin me stafin pedagogjik dhe studentet si dhe dokumentat e vena në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen "Ditët e informimit të maturantëve" në gjimnazet kryesore të qarkut Gjirokastër dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në Fakultet.<br>UGJ harton dhe publikon përpara çdo viti kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, duke u bazuar në vendimet e Senatit Akdemik në mbështetje të kritereve kombëtare, të propozuara nga njësitë bazë. Programi i studimit Bachelor në "Infermieri Mami" ofrohet në gjuhën shqipe dhe këtë program studimi mund ta ndjekin dhe studentë që vijnë nga trojet shqipfolëse. |
| | |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca II.10 Vendim Senati Akademik për kuotat 2020 -2021; Evidenca II.10.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021; Evidenca II.10.2 Raporti i verifikimit të kapaciteteve pritëse 2020-2021; Evidenca II.10.3 Udhezim Nr.10 date 15.05.2019 Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit ne IAL; Evidenca II.11 Vendim Senati Akademik për kuotat 2021-2022; Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022)* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | GVJ konstatoi se UGJ në rregulloren e programit të studimit ka informacion në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit ku studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në këtë rregullore citohet se UGJ ofron mundësi për transferime studentësh hyrëse dhe dalëse në vite të ndërmjetme, ndërmjet programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucione të tjera, pavarësisht se në programin e studimit Infermieri Mami nuk rezulton të ketë transferime.<br><br>*(Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca V.14 Lista e studenteve te larguar ose transferuar; Evidenca V.14 Lista e të transferuaeve dhe të larguarve nga UGJ)* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | GVJ konstatoi se UGJ merret seriozisht me informimin e publikut duke marrë pjesë në Panairet work & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura në UGJ për maturantët. Gjithashtu ofron informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare ëeb, rrjeteve sociale, etj.<br><br>*(Evidenca V.4 Kalendari i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantë; Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve; Evidenca V.4.3 Fletëpalosje UGJ; Evidenca V.4.4 Poster UGJ; Evidenca II.15 Pjesmarrje ne panairin Ëork and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesmarrje ne pnairin Ëork and Study 2023)* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | GVJ konstatoi se infrastruktura e UGJ, e vënë në dispozicion, është përshtatshme për t'u aksesuar si me këmbë ashtu edhe me mjete ndihmëse për studentët me aftësi të kufizuara. Në këtë mënyrë sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta. Gjithashtu politikat e UGJ nuk përbëjnë diskriminim për njerëz me përkatësi të ndryshme.<br><br>*(Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuar; Evidenca II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020)* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti | UGJ i ofron mundësi studentëve që vijnë nga trojet apo shtetas të huaj për të ndjekur studimet në gjuhën shqipe. Nërpërmjet faqes Web të |

| | |
|---|---|
| akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UGJ, fletë palosjeve, reklamave televizive, Zyrës së karrierës dhe këshillimit, ofron informacion për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. Megjithatë nuk u konstatua pjesëmarrja e këtij kontigjenti në këtë universitet.<br>*(Evidenca V.4 Kalendari i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantë; Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve; Evidenca V.4.3 Fletëpalosje UGJ; Evidenca V.4.4 Poster UGJ; Evidenca II.15 Pjesmarrje ne panairin Ëork and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesmarrje ne pnairin Work and Study 2023)* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | GVJ konstatoi se UGJ ka politika mbështetëse për shtetas në nevojë duke i mbështetuar ata nga ana ekonomike, duke ulur tarifat për vitin akademik sipas rasteve.<br>*(Evidenca II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020; Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuar)* |
| **Konkluzione** | *Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët.*<br>*Programi i studimit Bachelor në "Infermieri Mami" ofrohet në gjuhën shqipe dhe këtë program studimi mund ta ndjekin dhe studentë që vijnë nga trojet shqipfolëse. GVJ konstatoi se UGJ në rregulloren e programit të studimit ka informacion në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit. Kështu që studentët kanë mundësi të informohen në lidhje me transferimin apo ndjekjen e fakulteteve të dyta. GVJ konstatoi se UGJ ka politika mbështetëse për shtetas në nevojë duke i mbështetuar ata nga ana ekonomike, duke ulur tarifat për vitin akademik sipas rasteve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në | GVJ, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të ëeb si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në |





| | |
|---|---|
| lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga zyra e karrierës, përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik në lidhje me rregulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuntimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj.<br><br>*(Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Faqja WEB e UGJ; Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Takimi me përgjegjësin e njësisë bazë,studentët dhe stafin akademik)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ konstatoi se UGJ në rregulloren e programit të studimit ka informacion në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit ku studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në këtë rregullore citohet se UGJ ofron mundësi për transferime studentësh hyrëse dhe dalëse në vite të ndërmjetme, ndërmjet programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucione të tjera.<br><br>*(Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca V.14 Lista e studenteve te larguar ose transferuar; Evidenca V.14 Lista e të transferuaeve dhe të larguarve nga UGJ)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | GVJ konstatoi nga vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Studentët informuan GVJ se në cdo javë të parë te semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për cdo lëndë duke u njohur me syllabusin e lëndës.<br><br>*(Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.7 Regullore e Departamentit Infermieri e pergjithshme; Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca II.28 Syllabus Mami 2022-2023; Evidenca II.28.1 Syllabus Mami 2021-2022; Evidenca II.28.2 Syllabus Mami 2020-2021; Evidenca III.13 Rregullore e Sekretarise mesimore; Takim me studentët)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në "Infermieri Mami" përmbyllet me zhvillimin e provimit përfundimtar që zhvillohet me teze ose mbrojtje diplome me temë. Kjo bazuar në rregulloren e programit të studimit Neni 11, pika a.<br>Në fillim të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studenteve listën e lëndeve, mënyrën e zhvillimit të tezës, orientim për pyetjet që mund të bien, etj. Departamenti përcakton datën e zhvillimit |

| | |
|---|---|
| | të provimit të diplomës që miratohet nga Dekani. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 5.5 kredite (3%). Praktika profesionale është e parashikuar në Programine studimit Bachelor në "Infermieri Mami" në vitin e dytë dhe të tretë si Praktikë profesionale 1 dhe 2, dhe ka 20 kredite.<br><br>*(Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.7 Regullore e Departamentit Infermieri e pergjithshme; Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca III.11 Program i provimit te pergjithshem perfundimtar Bachelor Infermier – Mami)* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | GVJ konstatoi se UGJ përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panairet work & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura në UGJ për maturantët. Gjithashtu ofron informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare ëeb, rrjeteve sociale, etj. Të interesuarit kanë të gjithë informacionin e nevojshëm përpara fillimit të vitit akademik.<br><br>*(Evidenca V.4 Kalendari i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantë; Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve; Evidenca V.4.3 Fletëpalosje UGJ; Evidenca V.4.4 Poster UGJ; Evidenca II.15 Pjesmarrje ne panairin Ëork and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesmarrje ne pnairin Ëork and Study 2023)* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UGJ në rregulloren e programit të studimit ka informacion në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit ku studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.*<br>*GVJ konstatoi nga vizita me studentet se ata informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit.*<br>*GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në "Infermieri Mami" përmbyllet me zhvillimin e provimit përfundimtar që zhvillohet me teze ose mbrojtje diplome me temë.*<br>*GVJ konstatoi se UGJ përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panairet work & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura në UGJ për maturantët.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statutit, takimit me drejtues te institucionit, sekretarine mësimore, studentët konstaton se, UGJ vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Karrieres dhe stafin pedagogjik, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit.<br><br>*(Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.7 Regullore e Departamentit Infermieri e pergjithshme; Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca II.29 Struktura mesimore Bachelor Infermier – Mami; Takimi me studentët; stafin akademik; sekretarinë mësimore)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | GVJ bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: UGJ informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në "Infermieri Mami". Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet ëeb-it. Po ashtu në orën e parë studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti leksion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj.<br><br>*(Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.7 Regullore e Departamentit Infermieri e pergjithshme; Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Evidenca II.28 Syllabus Mami 2022-2023; Evidenca II.28.1 Syllabus Mami 2021-2022; Evidenca II.28.2 Syllabus Mami 2020-2021; Evidenca II.29 Struktura mesimore Bachelor Infermier – Mami; Faqe Ëeb UGJ; Takimi me studentët; stafin akademik; sekretarinë mësimore)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | UGJ vë në dispozicion Zyrën e këshillimit të karrierës për studentët që kanë paqartësi në lidhje me orientimin apo mundësitë e punësimit. Kjo zyrë organizon ëorkshope të ndryshme. Gjithashtu gjate Panairit të punës, kjo zyrë ka mundësi të reklamojë mundësitë e punësimit. ***Megjithatë nuk ndonjë të dhënë sesa punësime ka realizuar kjo zyrë.***<br><br>*(Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës; Evidenca V 13. Formular kontakti zyra alumni, keshillimit te karrieres-student)* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentoi që studentët informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programmit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.<br><br>*(Evidenca III.11 Program i provimit te pergjithshem perfundimtar Bachelor Infermier – Mami; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ; Evidenca II.28 Syllabus Mami 2022-2023; Evidenca II.28.1 Syllabus Mami 2021-2022; Evidenca II.28.2 Syllabus Mami 2020-2021; Evidenca II.29 Struktura mesimore Bachelor Infermier – Mami; Faqe Ëeb UGJ; Takimi me studentët; stafin akademik)* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | GVJ konstatoi se UGJ informon studentët nëpërmjet faqes zyrtare ëeb të UGJ dhe sistemit Pitagora. Studentët me anë të profilit të tyre individual në PITAGORA mund të futen në cdo moment dhe të kontrollojnë statusin e tyre dhe të marrin informacionet që i nevojiten.<br><br>*(Evidenca 3.13 Faqja ËEB e universitetit; Sistemi PITAGORA)* |
| **Konkluzione** | *GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statutit, takimit me drejtues te institucionit, sekretarine mësimore, studentët konstaton se, UGJ vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. UGJ informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për programin e studimit Bachelor në "Infermieri Mami". UGJ vë në dispozicion Zyrën e këshillimit të karrierës për studentët që kanë paqartësi në lidhje me orientimin apo mundësitë e punësimit.*<br>*GVJ konstatoi se UGJ informon studentët nëpërmjet faqes zyrtare ëeb dhe sistemit Pitagora.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

<table>
<tr><th colspan="2">Standardi V.4<br>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</td><td>Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UGJ mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore mbante informacion në lidhje me studentët e regjistruar duke ju referuar udhëzimeve të MAS dhe QSHA, në formë fizike dhe elektronike.<br><br>(Takimi me sekretarinë mësimore; Evidenca II.10.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021; Evidenca II.10.3 Udhezim Nr.10 date 15.05.2019 Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit ne IAL; Evidenca II.11.3 Baza ligjore QSHA dhe RASH per pranimet e reja; Evidenca V.3 Dosja personale e studentit nga hyrja deri ne diplomim; Evidenca V.14 Lista e studenteve te larguar ose transferuar)</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</td><td>Gjatë vizitës në UGJ, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:<br><br>
<table>
<tr><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th><th>Transferime</th><th>Totali</th></tr>
<tr><td>2020-2021</td><td>7 studentë</td><td>0</td><td>7 studentë</td></tr>
<tr><td>2021-2022</td><td>14 studentë</td><td>0</td><td>14 studentë</td></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>12 studentë</td><td>0</td><td>12 tudent<br>ë</td></tr>
</table>
<br>(Anekse Infermier – Mami; Evidenca II.10.3 Udhezim Nr.10 date 15.05.2019 Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit ne IAL; Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022; Evidenca II.11.3 Baza ligjore QSHA dhe RASH per pranimet e reja; Evidenca II.13 Vendim Senatit Akademik për kriteret 2022-2023; Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023)</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe</td><td>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UGJ. Në sekretarinë mësimore ndodhej i gjithe dokumentacioni i duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. I gjithë informacioni ruhej</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | në formë fizike dhe elektronike. UGJ ka përdorur sistemin elektronik ESSE3 dhe tashmë sistemin Pitagora.<br><br>*(Evidenca III.13 Rregullore e Sekretarise mesimore; Takimi me sekretarinë mësimore; Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Sekretarisa Mësimore e UGJ është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ, në nivel institucioni e cila zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Nga vizita që patëm në zyrat e sekretarisë, GVJ konstatoi se i gjithë dokumentacioni ishte në rregull. UGJ përdorur elektronik sistemin Pitagora. Pitagora është një sistem që menaxhohet nga AKKSHI. Gjithashtu sekretaritë mësimore kontrollohen nga Kryesekretrja me një grup pune, bazuar ne aktet rregullatore te brendshme.<br><br>*(Evidenca III.13 Rregullore e Sekretarise mesimore; Takimi me sekretarinë mësimore; Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3)* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Referuar RVB-së, Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim. Pikërisht nga këto të dhëna institucioni bën një raport vjetor të veprimtarisë së mësimdhënies dhe merr masa në funksion të ecurisë sa më të mirë të programit të studimit.<br><br>*(Evidenca 17 Raporti vjetor viti akademik 2021-2022; Evidenca 17.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e Raportit vjetor 2021-2022; Evidenca 18 Raporti vjetor viti akademik 2020-2021; Evidenca 18.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e raportit vjetor 2020-2021; Evidenca 19 Raport i vjetor viti akademik 2019-2020; Evidenca 19.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e raportit vjetor 2019-2020; Evidenca I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2019-2020; Evidenca I.12.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2020-2021; Evidenca I.12.4 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2021-2022; Evidenca I.13 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2021-2022* |
| **Konkluzione** | *UGJ mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore mbante informacion në lidhje me studentët e regjistruar duke ju referuar udhëzimeve të MAS dhe QSHA, në formë fizike dhe elektronike. Ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UGJ. Në sekretarinë mësimore* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *ndodhej i gjithe dokumentacioni i duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. I gjithë informacioni ruhej në formë fizike dhe elektronike (sistemi Petagora). Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se insttiucioni bazuar në Rregulloren dhe Statutin e saj u mundëson studentëve përfaqësimin në organet vendimmarrëse si në:<br>- Senatin Akademik;<br>- Grupet e RBV;<br>- Këshillin studentor;<br>- NJSBC<br><br>*(Evidenca 1 Statuti i UGJ; Evidenca II.2 Rregullore e Senatit Akademik; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca V 10.2 Vendim FSHN per miratimin e ngritjes se GVB; Evidenca 13 Rregullore e organizimit te zgjedhjeve per Keshillin Studentor; Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | GVJ konstaton se aktualisht UGJ përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave bëhet nga NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu departamenti përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe stafit të programit të studimit. Gjithashtu mendimi i studentëve merret në konsideratë në çdo nivel përfaqësimmi si në Senatin Akademik, Këshillat studentorë, NJSBC, grupet e RBV, duke bërë të mundur që ata të jenë një zë i fuqishëm në vendimmarrje. |

| | |
|---|---|
| | *(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023; Rregullore e Senatit Akademik; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca V 10.2 Vendim FSHN per miratimin e ngritjes se GVB; Evidenca 13 Rregullore e organizimit te zgjedhjeve per Keshillin Studentor; Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC)* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në procese akademike me pjesëmarrje në NJSBC, GVB, Senat akademik, gjë e cila garanton dëgjimin e zërit të studentëve në vendimmarrje. Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyestorëve. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagut të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi.<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023)* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije.<br><br>*(Evidenca I.7 Regullore e Departamentit Infermieri e pergjithshme; Evidenca I.9 Rregullore e Programit te studimit Bachelor Infermier – Mami; Raport Vleresimi i Brendshem Infermier Mami; Takimi me studentë dhe stafin akadmeik)* |

| | |
|---|---|
| **Konkluzione** | *UGJ bazuar në Rregulloren e UGJ si dhe Statutin e UGJ u mundëson studentëve përfaqësimin në organet vendimmarrëse si në: Senatin Akademik; Grupet e RBV; Këshillin studentor; NJSBC. Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet stafit akademik të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | UGJ ka në organigramë dhe Zyrën Këshillimit të Karrierës. GVJ konstatoi se kjo zyrë realizon informimin e studentëve që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Studentët gjithashtu informohen edhe nga faqja e ëebit e cila përditësohet vazhdimisht.<br><br>*(Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës; Evidenca V 13. Formular kontakti zyra alumni, keshillimit te karrieres-student; Faqja ËEB e universitetit)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Nga kontakti i GVJ me studentët, konstatoi se ata ishin të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Stafi akademik dhe Zyra e Karrierës luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.<br><br>*(Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës; Evidenca V 13. Formular kontakti zyra alumni, keshillimit te karrieres-student; Evidenca III.13 Rregullore e Sekretarise mesimore; Takimi me studnetë dhe stafin akademik)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e | Nga takimi i GVJ me studentët u konstatua se Zyra e këshillimit të karrierës funksiononte në mënyrë të vazhdueshme duke mbajtur |

| | |
|---|---|
| këshillimit të karrierës.<br>Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | leksione të hapura, trajnime dhe duke përfshirë studentët në panairet e punës. Studentët referuan se ishin të kënaqur nga zyra e këshillimit të karrierës. Kjo zyrë i ndihmon ata për:<br>- Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune;<br>- Udhëheqje akademike;<br>- Identifikimin e shprehive dhe aftësive;<br><br>*(Evidenca V.13.1 Korrespodenca për Këshillimin e karrierës; Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës; Evidenca V 13. Formular kontakti zyra alumni, keshillimit te karrieres-student; Evidenca II.15 Pjesmarrje ne panairin Ëork and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesmarrje ne pnairin Ëork and Study 2023; Evidenca I.26 Leksione të hapura)* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ konstatoi nga dokumentet dhe nga takimi me zyrën e karrierës se realizohen aktivitete si: Këshillim individual i karrierës, Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminare, konferenca, panairet e punës, etj. Në këtë formë UGJ ndjek studentët pas diplomimit dhe monitoron shkallën e punësimit. Kontaktet me ish-studentët realizohen me anë të adresave email, ku zyra merr informacion të përditësuar në lidhje me karrierën e tyre.<br><br>*(Evidenca V.13.1 Korrespodenca për Këshillimin e karrierës; Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punes Zyra Alumni, Keshilli i karrieres 22-23; Evidenca V 13. Formular kontakti zyra alumni, keshillimit te karrieres-student; Evidenca VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës; Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Te dhena statistikore nga zyra e alumni)* |
| **Konkluzione** | *UGJ ka në organigramë dhe Zyrën e Informimit dhe Zhvillimit të Karrierës. Stafi akademik dhe Zyra e Karrierës luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Zyra e karrierës se realizohen aktivitete si: Këshillim individual i karrierës, Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminare, konferenca, panairet e punës, etj. Në këtë formë UGJ ndjek studentët pas diplomimit dhe monitoron shkallën e punësimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, UGJ, e ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. UGJ organizon trajnime për personelin akademik në lidhje me mësimdhënien në mënyrë që të realizohen metoda të ndryshme dhe inovative për mësimdhënien.<br><br>*(Evidenca III.5 Udhezues mbi zhvillimin dhe perdorimin e metodave te ndryshme dhe innovative te mesimdhenies; Evidenca III.15 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore te UOGJ 2019-2020; Evidenca III.15.1 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore te UOGJ 2021-2022; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore te UOGJ 2022-2023; Evidenca 7 Strategjia e kerkimit shkencor në UGJ)* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë UGJ mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga UGJ, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Mekanizmat kryesorë që përdoren janë:<br>- Pyetsori i studentëve;<br>- Vlerësimi i perfomancës akademike;<br>- Monitorimi i vazhdueshëm i procesit mësimor nga përgjegjësi i departamentit;<br>***GVJ gjykon se NJSBC-ja është një strukture e re, por ka vizion të qartë në punën e saj, ku çdo vit bën një relacion në lidhje me cilësinë e mësimdhënies.***<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca 1 Statuti i UGJ; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Takimi me drejtuesin e njësisë bazë)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | UGJ ka përfshirë studentët në NJSBC, GVB dhe Senat akademik ku ata kanë mundësi të japin mendimin e tyre në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve dhe trajtimin e ankimeve. Studentët kontribuojnë në cilësinë e programit të studimit, edhe nëpërmjet angazhimit në Këshillat studentorë, të cilët mbajnë lidhje të ngushtë me Institucionin, Njësinë kryesore dhe vecanërisht me Njësinë bazë. UGJ organizon pyetësorë për studentët në lidhje me ecurinë e programit mësimor.<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca II.2 Rregullore e Senatit Akademik; Evidenca V.10.1 Vendim per ngritjen e GVB Infermier – Mami; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve)* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Siç u theksua më lart pranë UGJ funksionon NJSBC, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetsorin e studentëve. Një herë në vit kjo strukturë shpërndan pyetsorin studentor për cilësinë e mësimdhënies. Institucioni harton raportin në fund të cdo viti akademik i cili publikohet në faqen zyrtare të Universitetit, me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë nga institucioni.<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Referuar vizitës në Institucion, në takimin me stafin akademik të këtij program studimi GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështjetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashmë shkencore).<br><br>*(Takimi me stafin akademik; Takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe kryesore Evidenca III.15 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore te UOGJ 2019-2020; Evidenca III.15.1 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore te UOGJ 2021-2022; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore te UOGJ 2022-2023; Evidenca III.15.3 Plani i veprimtarisë së DMIF 2019-2020; Evidenca II.21 Urdher MAS per perzgjedhjen e literatures ne IAL)* |
| **Konkluzione** | *UGJ ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. UGJ ka* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *përfshirë studentët në NJSBC, GVB dhe Senat akademik ku ata kanë mundësi të japin mendimin e tyre në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve dhe trajtimin e ankimeve. Pranë UGJ funksionon NJSBC, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetsorin e studentëve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015 dhe Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018), institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UGJ dhe në rregulloren e institucionit. Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Nga të dhënat e pyetësorëve bëhen raporte të cilat merren në konsideratë për të realizuar analizën vjetore të mësimdhënies. Gjithashtu IAL-ja ka një plan vjetor në lidhje me veprimtarinë për sektorin e standradeve të cilësisë dhe e bazon punën e saj ne këtë dokument.<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca 1 Statuti i UGJ; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | UGJ ka në organigramë Njësisë së Brendshme të Sigurimit të cilësisë e cila siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit. Kjo strukturë përbëhet nga 7 anëtarë ku njëri është student. ***GVJ konsideron që NJSBC të ketë në përbërje të tij një aktor të jashtëm.*** UGJ bashkëpunon dhe me ASCAL dhe gjithashtu ka një monitorim të përvitshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për plotësimin e standardeve, gjë që siguron funksionimin e kontrollit të cilësisë.<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UGJ realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Konkretisht, UGJ ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar për herë të parë me VBA Nr. 67, datë 21.09.2017 dhe për herë të dytë me VBA 55, datë 16. 12. 2021. Programi i studimi Bachelor në "Infermieri-Mami", e kalon për herë të parë procesin e akreditimit. *(Evidenca I.21 .Vendim i Akreditimit Institucional periodik; Evidenca I.21.1 Plani i veprimit per Akreditimin institucional periodik)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | GVJ konstatoi se UGJ ka një komunikim të mirë nga poshtë lart dhe anasjelltas. Gjithashtu me anë të kontrollit të cilësisë dhe raportimit të tyre, UGJ arrin të promivojë arritjet më të mira. NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në vecanti Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor.<br><br>*(Evidenca I.13 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2021-2022)* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UGJ dhe në rregulloren e institucionit. UGJ ka në organigramë Njësisë së Brendshme të Sigurimit të cilësisë e cila siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit. Kjo strukturë përbëhet nga 7 anëtarë ku njëri është student.* ***GVJ konsideron që NJSBC të ketë në përbërje të tij dhe një aktor të jashtëm.*** *Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor. UGJ ka një komunikim të mirë nga poshtë lart dhe anasjelltas.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** |
|---|

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Të gjitha gjetjet e vlërësimit vjetor janë pjesë e raportit të njësisë bazë. GVJ konstatoi se UGJ kryen një vlerësim të brendshëm vjetor që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili gjithashtu dërgohet në MAS. Kontrolli i përvitshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve garanton plotësimin e standarteve.<br>***GVJ konstatoi se UGJ nuk merr informacion nga UISH. Provimi i UISH është një indikator i fuqishëm për të matur performancën e objektivave të arritura nga programi i studimit. GVJ konsideron që rezultatet e UISH të merren në konsideratë.***<br><br>*(Evidenca I.13 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2021-2022; Evidenca II.27 Raport vjetor i aktiviteit te grupit kerkimor te lendeve paraklinike; Evidenca II.27.1 Raport vjetor i aktivitetit te grupit kerkimor te lendeve klinike; Evidenca 17 Raporti vjetor viti akademik 2021-2022; Evidenca 18 Raporti vjetor viti akademik 2020-2021; Evidenca 19 Raport i vjetor viti akademik 2019-2020)* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezulton se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo semestri dhe çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve dhe pyetësorët për stafin akademik. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UGJ sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Në fund bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e përmirësimit dhe rekomandohen plan masat.<br><br>*(Evidenca I.13 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2021-2022; Evidenca II.27 Raport vjetor i aktiviteit te grupit kerkimor te lendeve paraklinike; Evidenca II.27.1 Raport vjetor i aktivitetit te grupit kerkimor te lendeve klinike; Evidenca I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2019-2020; Evidenca I.12.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2020-2021; Evidenca I.12.4 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2021-2022; Evidenca 17 Raporti vjetor viti akademik 2021-2022; Evidenca 18 Raporti vjetor viti akademik 2020-2021; Evidenca 19 Raport i vjetor viti akademik 2019-2020)* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | GVJ konstatoi se UGJ përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programit.<br>Diskutimet e hapura të stafit akademik me studentët në lidhje me procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimeve të provimeve apo detyrave të kurseve, etj, janë metoda e drejtpërdrejtë që UGJ përdor të sigurar vlerësimin e cilësisë.<br>***GVJ konsideron që UGJ duhet të marrë informacion nga UISH dhe ta përdorë atë si një metodë për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programit.***<br><br>*(Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Evidenca I.13 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2020-2021)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | UGJ në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programet e studimit përdor mekanizimat e mëposhtëm kryesorë:<br>- Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve;<br>- Sondazhi Kombëtar i Studentëve;<br>- Mendime nga ALUMNI;<br>- Raportet e stafit akademik gjatë vitit shkollor .<br>Të gjitha këto të dhëna bëjnë të mundur realizimin e analizës mësimore vjetore pranë UGJ.<br><br>*(Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Evidenca V.13.1 Korrespodenca për Këshillimin e karrierës; Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punes Zyra Alumni, Keshilli i karrieres 22-23; Evidenca I.13 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarise mesimore DIF 2021-2022)* |
| **Konkluzione** | *UGJ kryen një vlerësim të brendshëm vjetor që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili gjithashtu dërgohet në MAS.*<br>*Diskutimet e hapura të stafit akademik me studentët në lidhje me procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimeve të provimeve apo detyrave të kurseve, etj, janë* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *metoda e drejtpërdrejtë që UGJ përdor të sigurar vlerësimin e cilësisë. IAL përdor edhe metoda të tërthorta vlerësusese sic janë sondazhet e studentëve, sondazhi kombëtar i studentëve, mendimet alumni, etj.* ***GVJ konsideron që UGJ duhet të marrë informacion nga UISH dhe ta përdorë atë si një metodë përr lerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programit.*** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Sipas rregullores së NJSBC në përbërje të tij ka 7 anëtarë ku një është përfaqësues të studentëve. ***GVJ konsideron që në mënyrë që të garantohet se politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshijnë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duhet që njëri nga antarët e NJSBC të jetë i jashtëm.*** Struktura më e aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe vecanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje më standardet e cilësisë se UGJ, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UGJ, në NJSBC, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL.<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca VI.8.1 Vendim Senati për miratimin e NJSBC në UGJ Evidenca VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Në takimin e realizuar me stafin dhe studentët, GVJ u informua se studentët përfshihen në vlerësimin periodik institucional përmes anketimit. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit te studimit, eshtë konceptuar si përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:<br>- Harmonizimin e veprimtarise të të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit;<br>- Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe pëmirësuar cilësinë e programit të studimit; |

| | |
|---|---|
| | - Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave te përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë,<br>GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkëpunues dhe të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë.<br>Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.7 Regullore e Departamentit Infermieri e pergjithshme; Evidenca V.10.1 Vendim per ngritjen e GVB Infermier – Mami; Evidenca V.10.3 Vendim senati per miratimin e GVB per programet e studimit)* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, me drejtues, stafin akademik, studentët konstaton dhe mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit. GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC ka përfaqësues të njësisë kryesore, njësisë bazë, 4 anëtarë të personelit akademik, 2 të personelit ndihmës akademik dhe përfaqësuesin e studentëve.<br>***GVJ konsideron që njëri nga anëtarët të ishte aktor i jashtëm i fushës së shëndetësisë.***<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Evidenca 20 Raport auditimi per performancen ne periudhen e pandemise)* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie | GVJ mendon se UGJ është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhja e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga personeli akademik ku merren parasysh disa kritere të përfshirjes si, performanca akademike, integriteti, kompetencat profesionale; mundësitë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim |

| | |
|---|---|
| kundrejt personelit dhe studentëve. | realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget cdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve.<br>***GVJ konstaon se antarër e GVB janë vetëm mjek dhe një student. GVJ rekomandon që si përbërje e GVB të jetë domosdoshmërisht anëtarët të deparetamentit të profilit infermieror dhe një antarë të jashtëm të profilit mjekësor.***<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ; Evidenca III 6.1 Analiza e pyetesorve dhe percjellja ne fakultet; Evidenca III.6 Procedura per ngritjen e punes dhe zhvillimi i pyetsorit; Evidenca VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve; Evidenca 20 Raport auditimi per performancen ne periudhen e pandemise; Evidenca VI.1 Vendim Senati akademik për miratimin e programit të trasparencës 2021; Evidenca VI.2 Vendim Senati akademik për miratimin e programit të trasparencës 2023 i rishikuar; Evidenca VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ)* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Qëllimi i NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon me bazë Rregulloren për Sigurimin e Cilësise; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendëshme të UGJ dhe Statutit të UGJ. Po ashtu dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL shërben për sigurimin të cilësisë, në lidhje me programin e studimit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe më pas nga GVJ me anë të RVJ, pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë. GVJ konstatoi se detyrat dhe roli i anëtarëve të NJSBC përcaktohen në rregulloren e funksionimit të NJSBC.<br>***Në nenin 4 të rregullores së NJSBC parashikohet përbërja e e saj me 7 anëtarë. GVJ konsideron që në përbërje të NJSBC duhet të jetë një aktor i jashtëm.***<br><br>*(Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca 1 Statuti i UGJ; Evidenca IV.17.1 Raport i MASR AUDIT 2018; Evidenca IV.17.2 Raport i MAS AUDIT 2022)* |
| **Konkluzione** | *Sipas rregullores së NJSBC në përbërje të tij ka 7 (neni 4) anëtarë ku një është përfaqësues të studentëve. Struktura më e aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe vecanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje më standardet e cilësisë se UGJ, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Në rregulloret e* |

| | |
|---|---|
| | *institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë.*<br>*Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget cdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve.* ***GVJ konsideron që në përbërje të NJSBC duhet të jetë një aktor i jashtëm.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | GVJ konstatoi se aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të UGJ janë të aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët si dhe çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurmin e Cilësisë në UGJ. Këto të dhëna janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara. Në faqen zyrtare web të UGJ bëhen publike rezultate të pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Rektoratit, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj.<br><br>*(Evidenca 2 Rregullore e brendshme e UGJ; Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC; Evidenca VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca 1 Statuti i UGJ)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej UGJ konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. UGJ ka të miratuara rregullore të funksionimit të programeve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen web publikohen të gjitha politikat dhe praktikat e sigurimit të cilësisë të cilat janë të akesueshme për të gjithë. Në takim me drejtues të institucionit sic jemi shprehur dhe në standartet e mësipërme, GVJ u informua se, NJSBC kryhen në mënyrë periodike shpërndarjen e pyetësorëve për të cilët është punuar edhe menduar që të jenë të personalizuar. Ato shpërndahen në mënyrë elektronike anonime me link përpara fillimit të sezonit të provimeve. Informacioni i mbledhur i vihet në dispozicion drejtuesve të njësive bazë. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen zyrtare web për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.<br><br>*(Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC)* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik. Ky raport i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkret. Ky raport vjetor i bëhet i ditur çdo pedagogu, diskutohet në departamente dhe secili ka mundësi të reflektojë në lidhje me problematikat e ndryshme që mund të hasen.<br><br>*(Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023; Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | GVJ konstatoi se UGJ për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatin Akademik të UGJ për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohen dhe një raport vjetor. Në këtë raport shqyrtohen problematikat dhe veprimet që duhen të ndërmerren për të siguruar përmirësimin.<br><br>*(Evidenca 17 Raporti vjetor viti akademik 2021-2022; Evidenca 17.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e Raportit vjetor 2021-2022; Evidenca 18 Raporti vjetor viti akademik 2020-2021; Evidenca 18.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e raportit vjetor 2020-2021; Evidenca 19 Raport i vjetor viti akademik 2019-2020; Evidenca 19.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e raportit vjetor 2019-2020)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | GVJ konstaton një punë të mirë të bërë nga grupi i NJSBC në lidhje me ndërgjegjësimin për sigurimin e cilësisë në programin mësimor. Kjo strukturë planifikon dhe raporton çdo vit në lidhje me standardet e cilësisë. Edhe pse është një strukturë e re, kjo njësi ka një rregullore mbi të cilën orienton dhe punën e saj. Raportet e kësaj strukture merren në konsideratë për raportin vjetor mësimor të UGJ.<br><br>*(Evidenca VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023; Evidenca 17 Raporti vjetor viti akademik 2021-2022; Evidenca 17.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e Raportit vjetor 2021-2022; Evidenca 18 Raporti vjetor viti akademik 2020-2021; Evidenca 18.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e raportit vjetor 2020-2021;* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Evidenca 19 Raport i vjetor viti akademik 2019-2020; Evidenca 19.1 Vendimi i SA dhe BA per miratimin e raportit vjetor 2019-2020)* | | | |
| **Konkluzione** | *Aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të UGJ janë të aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët si dhe çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurmin e Cilësisë në UGJ. UGJ konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. UGJ ka të miratuara rregullore të funksionimit të programeve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave.*<br>*UGJ për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatin Akademik të UGJ për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohen dhe një raport vjetor.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Infermier-Mami" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Gjirokastrës Eqrem Çabej"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Pozicioni gjeografik i jep UGJ avantazhin e krijimit të një qendre rajonale universitare dhe të edukimit në vazhdim. Njohja e nevojave të tregut lokal të punës është një mundësi për planifikim më të mirë të burimeve akademike dhe infrastrukturore, për një planifikim më të mirë të programeve të studimit dhe punës kërkimore – shkencore.
2. Eksperienca e operimit të UGJ dhe FSHN në fushën e mësimdhënies. Departamenti i Infermierisë ka një grup mjekësh me përvojë dhe pedagogë të rinj me ambicie për të fituar tituj e grada në kuadër të projekteve nacionale dhe internacionale që krijojnë qëndrueshmëri në mësimdhënie dhe garanci për trajnimin dhe përfshirjen në proçesin mësimdhënës të infermierëve dhe mamive.
3. Infrastruktura universitare dhe bashkëpunimi me spitalin rajonal "Omer Nishani" krijojnë kushtet optimale për realizimin me teknologji bashkëkohore të mësimit teorik dhe praktik (laboratore e seminare) si dhe të praktikës profesionale.
4. Faqja web siguron informim dhe transparencë. Informacioni rinovohet në mënyrë të vazhdueshme.

**Pika të dobta:**

1. Mungesa e marrëveshjeve me Drejtorinë rajonale të shëndetësisë si dhe me qendra konsultore e poliklinike për të siguruar praktikë profesionale në të gjitha fushat e ekspertizës që janë qëllim i programit të studimit Bachelor "Infermier-Mami". **(Standardi I.2 kriteri 3, Standardi II.4 kriteri 3)**
2. Mungesa e PAE me formim Mjek Obstetër-Gjinekolog, Infermier i Përgjithshëm dhe Mami për realizimin e programit teorik-praktik në fushën e lëndëve karakterizuese, profesionale të fushës infermieristike dhe mami. Numri i madh i lëndëve (mbi 3) të specialiteteve të ndryshme që jepen nga disa pedagogë (p.sh. lindje normale, radiologji, fizioterapi) në ndonjë rast pa përputhje me fushën e ekspertizës së pedagogut. **(Standardi II.2 kriteri 1, Standardi III.1 kriteri 4)**
3. Mungesa e koordinatorit të programit të studimit. **(Standardi II.2 kriteri 3)**
4. Mungesa e rregullores së praktikës profesionale dhe numri i vogël i praktikave laboratorike për lëndët e profilit infermieror dhe mami. **(Standardi II.3 kriteri 1)**
5. Përditësimi i literaturës në syllabuse. **(Standardi II.3 kriteri 4)**

**Rekomandime:**

1. GVJ rekomandon që të realizohet marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin Shëndetësor Parësor dhe të bëhet e mundur zhvillimi i një pjesë të orëve të praktikave profesionale në këtë sistem. Rekomandohet shkrimi i rregullores së praktikës profesionale dhe shtimi i orëvenë dispozicion të saj.

2. Të shtohet numri i personelit akademik me kohë të plotë në profilet infermier e mami dhe orët e lëndëve me karakter infermiror të jepen pikërisht nga profesionistët e kësaj fushe.
3. Përditësimin e syllabuseve dhe CV të personelit akademik. Në syllabuse të shihet mundësia e shtimit të orëve të praktikave laboratorike në lëndët infermierore.
4. Rekomandohet emërimi i koordinatorit të programit të studimit dhe përfshirja në GVB e një personeli akademik në fushën infermieri apo mami dhe një aktor të jashtëm të fushës mjekësore.
5. Të mbahet kontakt me UISH në lidhje të dhënat që disponon dhe ti përdorë në favor të përmirsimit të cilësisë së programit të studimit.
6. Të shtohen përpjekjet e angazhimit të studentëve në pjesëmarrje aktive në punime kërkimore shkencore.

**Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Nursing-Midwifery" offered by the Institution of Higher Education "University of Gjirokastra Eqrem Çabej"**

**Strengths and Affirmations:**

1. The geographical position gives UGJ the advantage of creating a regional university and continuing education center. Knowing the needs of the local labor market is an opportunity for better planning of academic and infrastructural resources, for better planning of study programs and research-scientific work.
2. The operating experience of UGJ and FSHN in the field of teaching. The Department of Nursing has a group of experienced doctors and young pedagogues with ambitions to acquire titles and degrees within national and international projects that create stability in teaching and guarantee training and involvement in the teaching process of nurses and midwives.
3. The university infrastructure and the cooperation with the regional hospital "Omer Nishani" create optimal conditions for the implementation of theoretical and practical learning (laboratory and seminars) and professional practice with modern technology.
4. The website provides information and transparency. The information is updated continuously.

**Weaknesses:**

1. The lack of agreements with the regional Health Directorate as well as with consulting and polyclinic centers to ensure professional practice in all areas of expertise that are the purpose of the "Nurse-Midwife" Bachelor study program. **(Standard I.2 criterion 3, Standard II.4 criterion 3)**
2. Absence of EAS with Obstetrician-Gynecologist, General Nurse and Midwife training for the realization of the theoretical-practical program in the above-mentioned fields, specific professional subjects related to nursing and midwifery. The large number of courses (over 3) of different specialties taught by some lecturers (eg normal delivery,

radiology, physiotherapy) in any case without matching the lecturer's field of expertise. **(Standard II.2 criterion 1, Standard III.1 criterion 4)**

3. Absence of study program coordinator. **(Standard II.2 criterion 3)**
4. The lack of professional practice regulations and the small number of laboratory practices for nursing and midwife profile courses. **(Standard II.3 criterion 1)**
5. Updating the literature in the syllabus. **(Standard II.3 criterion 4)**

**Recommendations:**

1. EEG recommends that a cooperation agreement be made with the Primary Health Service and that it becomes possible to develop a part of professional practice hours in this system. It is recommended to write the regulation of the professional practice and increase the hours available to it.
2. To increase the number of full-time academic personnel in the profiles of nurses and midwives, and to teach nursing courses by professionals in this field.
3. Updating syllabi and CV of academic staff. In the syllabus, the institution should look for the possibility of adding more hours of laboratory practices to nursing subjects.
4. It is recommended to appoint the coordinator of the study program and include in the IEG an academic staff in the nursing or midwifery field and an external expert from the medical field.
5. To maintain contact with UISH regarding the available data and to use it in favor of improving the quality of the study program.
6. Increase efforts to engage students in active participation in scientific research works.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | X |
| **VLERËSIMI TËRËSOR** | | | | X |